



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”

ofruar nga

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As Mihallaq Qirjo

2. Dr. Genti Kromidha

Qershor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi” ofruar nga
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Univesiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave “Mbrojtje Mjedisi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 620, datë 11.06.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 281, datë 14.06.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Ofrohet vetëm nga UNIEL
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/3 PAK për vitin 2021-2022 10 PAE/3 PAK për vitin 2022-2023
18	Numri i studentëve:	18 studentë në vitin akademik 2021-2022 16 studentë në vitin akademik 2022-2023
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Programi i studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, në proces vlerësimi në kuadër të akreditimit për herë të parë të tij, ofrohet nga Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Programi i studimit është licensuar me VKM Nr. 620, datë 11.06.2009. Ky program është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi ofrohet me 120 ECTS dhe me kohëzgjatje 2 (dy) vite akademike.

Stafi i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore. Në këtë program studimi, për këtë vit akademik, 2022-2023 japin mësim 10 (dhjetë) staf akademik efektiv dhe 3 (tre) staf akademik me kontratë.

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi në vitin akademik 2021-2022 është 18 studentë, dhe numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2022-2023 është 16 studentë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Grupi i vlerësuesve të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Prof. As. Mihallaq Qirjo dhe Dr. Genti Kromidha. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako.

GVJ mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) dhe vendosi realizimin e vizitës në Institucion më datë 16 dhe 17 Janar 2023, për të cilën u hartua edhe Agjenda e vizitës me takimet respektive.

Në bazë të Agjendës, GVJ realizoi në Institucion takime me: Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Përgjegjësin e Departamentit të Biologjisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në programin e studimit, studentët e programit të studimit nga të dy vitet, përfaqësues nga Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, përfaqësues nga Sektori i Personelit, përfaqësues nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Qendra për të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe realizoi një vëzhgim të mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) dhe një vizitë në Bibliotekën e Institucionit.

Gjatë vizitës u kërkuan disa dokumenta shtesë, të cilat u dërguan nga institucioni dhe iu vunë në dispozicion GVJ-së.


Mbi bazën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), informacionit të marrë gjatë takimeve të realizuara në Institucion, si dhe dokumentave shtesë të kërkuara gjatë vizitës në Institucion, GVJ ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).

Më datë 08.05.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/63 Prot., datë 08.05.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli përgjigjen mbi Draft-Raportin me shkresë Nr. 642/41 Prot., datë 12.05.2023, përmes së cilës është shprehur se nuk ka komente për Draftin. Për sa më lart, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm kthehet në Raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Mbrojtje Mjedisi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Biologjisë, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, pranë Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Fakulteti i Shkencave të Natyrës është një nga tre Fakultetet e para të Universitetit të Elbasanit, që në krijimin e tij, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 12.11.1991. Universiteti i Elbasanit është krijuar mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Siç theksohet në statutin e universitetit, ky fakultet, me një traditë disa vjeçare, ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe kontribuojnë në konsolidimin e vlerave akademike kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e tij të veprimtarisë.	Sipas Statutit të UNIEL, Neni 2 (Evidenca 1.1), disa nga pikat e Misionit të këtij Institucioni janë: <i>të fomojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor.</i> Sa më sipër, ky program studimi është në përputhje me Misionin dhe qëllimet e Universitetit të Elbasanit. Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet e ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	GVJ nisur edhe nga evidencat e paraqitura në Dosjen e Vetëvlerësimit mendon se programi i studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi” është një program në përputhje me objektivin kryesor të UNIEL, i cili është të formojë profesionistë të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit edhe në fushat e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit. Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL; Evidenca 1.3. Strategjia e UNIEL; Evidenca 1.4. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Sipas Strategjisë së Univesitetit të Elbasanit, ky institucion ka si qëllim të ruajë me fanatizëm programet e studimit themelues të tij dhe nga ana tjetër të pasurojë kurrikulën universitare me programe të reja studimi, siç është edhe programi Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, i cili është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe kërkesat e vazhdueshme për specialistë të mbrojtjes së mjedisit, në linjë edhe me prioritetet globale për një zhvillim të qëndrueshëm e qëndrim më të përgjegjshëm ndaj vlerave mjedisore.



Konkluzione	GVJ shprehet se programi i studimit Master i Shkencave në “Mbrotjtje Mjedisi” është hartuar në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Universitetit të Elbasanit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave të Natyrës, i cili ofron këtë program studimi, ka personel akademik të kualifikuar dhe me përvojë akademike. Sipas Strategjisë së UNIEL, pika 1.3 Burimet njerëzore, Univesiteti i Elbasanit ka synuar vazhdimisht garantimin e burimeve njerëzore duke rritur numrin e pesonelit akademik efektiv në mënyrë që ti përgjigjet sa më mirë procesit mësimor dhe raportit student-pedagog; si dhe forcimin e kapaciteteve dhe strukturave për garantimin e cilësisë si dhe rritjes së mobilitetit të stafit për të mundësuar marrjen e eksperiencave ndërkombëtare dhe vënien në funksion të lëndëve që mbulojnë në kuadër të programit të ofruar. Evidenca 1.3. Strategjia e UNIEL.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Mbrotjtje Mjedisi” ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Sipas Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Natyrës, veprimtaritë formuese që karakterizojnë programet që ofrohen në këtë Fakultet përbëhen nga komponentë mësimor si: mësim në auditor; studim individual; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; veprimtari të tjera si praktikë profesionale, praktika në terren apo edhe stazh pranë subjekteve private dhe publike. Sipas Evidencës ku jepen të dhëna të pasqyrimin të kodifikimit të programeve që ofron Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka një kodifikim të lëndëve sipas planeve mësimore të programeve të studimit. Megjithatë, ende nuk është përfunduar kodifikimi i programeve në rang kombëtar, sipas Udhëzimit të MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 “Për Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Evidencë 1.7. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Evidencë 1.9. Pasqyrimi i kodifikimit të programeve që ofron Fakulteti i Shkencave të Natyrës.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të	Sipas RVB dhe informacioneve të marra gjatë takimeve në institucion, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në “Mbrotjtje Mjedisi” është në harmoni të plotë me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Sipas Rregullores së Departamentit të Biologjisë, neni 1, ky Departament synon të ofrojë një formim akademik për të përgatitur profionistët e ardhshëm, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin

paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>rajonat dhe kombëtar të vendit duke synuar të përgatisin biologë, mësues biologjie dhe kimie, si dhe specialistë e teknikë të mjedisit me aftësi akademike, sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Programi i Studimit Mastër i Shkencave në “Mbrotjtje Mjedisit” nuk është program ndërdisiplinor.</p> <p>Evidenca 1.15. Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</p>		
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master Profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet për këtë program studimi pasi është Master i Shkencave.		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk aplikohet për këtë program studimi pasi është Master i Shkencave.		
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës i cili është një Fakultet i krijuar që në fillimet e funksionimit të këtij Institucioni. Programi është në përputhje edhe me Rregulloren e Departamentit të Biologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi. Programi nuk është program ndërdisiplinor.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësitëve e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Gjatë vizitës në institucion, në takim me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Përgjegjësen e Departamentit të Biologjisë u komunikua se për ofrimin sa më efektiv të këtij programi studimi ka një ndarje të qartë të detyrave por edhe marrëdhënieve bashkëpunuese si në nivel Departamenti ashtu edhe në nivel programi. Departamenti vazhdimisht mblidhet për të analizuar punën e tij në shërbim të mësimdhënies dhe të studentëve dhe për të identifikuar mangësitë apo edhe për të marrë masa konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda	Sipas Dosjes së Vetëvlerësimit por edhe gjatë vizitës në UNIEL, ky Institucion ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme. Sipas Evidencës 1.13 është paraqitur një listë me 60 Institucione bashkëpunuese në rang Universiteti. Veçanërisht të rëndësishme për këtë program studimi janë marrëveshjet me Universitetin e Tiranës (Fakulteti i Shkencave të Natyrës) dhe Universitetin Ismail

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Qemali Vlorë. Gjithashtu, nga takimi i GVJ me Dekanin, Përgjegjësen e Departamentit dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, u konfirmua se ka patur edhe bashkëpunime ndërkombëtare, kryesisht me Italinë dhe Poloninë për këtë program studimi.		
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Sipas Evidencës 1.14 të Dosjes së Vetëvlerësimit, Universiteti i Elbasanit ka lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave mësimore. Sipas kësaj evidence janë gjithsej 16 institucione me të cilat Universiteti i Elbasanit bashkëpunon që nga viti 2016 dhe deri më tani si: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Elbasan; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive; Bashkia Elbasan; Drejtoria Arsimore Rajonale, institucione të cilat mund të ndihmojnë studentët e programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi” për zhvillimin e praktikave lëndore ose profesionale. Sipas Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, aktualisht ka rezultuar frytdhënës bashkëpunimi i këtij institucioni me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe bizneset private për praktikat e studentëve të këtij programi.		
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Sipas Raportit të Vetëvlerësimit por edhe sipas bisedave të realizuara në institucion, GVJ konstaton se nuk ka raporte analitike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Për këtë qëllim, Departamenti dhe Fakulteti duhet të punojnë më fort për të hartuar raporte analitike me qëllim përfitimin sa më shumë nga marrëveshjet e lidhura në funksion të studentëve të këtij programi si për praktikat lëndore ashtu edhe për praktikat profesionale.		
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Institucioni duhet të punojë më shumë për të konkretizuar bashkëpunimet me Institucionet shtetërore dhe private duke i formalizuar në marrëveshje të ngushta bashkëpunimi për realizimin me sukses të praktikave lëndore por edhe atyre profesionale në funksion të realizimit sa më të suksesshëm të programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”. Gjithashtu duhet të realizojë raporte analitike për përfitimin nga këto marrëveshje bashkëpunimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Bazuar në Raportin e Vetëvlerësimit dhe vlerësimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" realizohet në përputhje me përcaktimet e dosjes së tij dhe Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Ky program është i organizuar në lëndë/module, peshë e të cilave vlerësohet me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sipas RVB dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dhënë në "Tabelat Përmbledhëse", programi i studimit është i shtrirë në dy vite akademike, në katër semestra. Çdo vit akademik ka një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij. Ngarkesa totale për të dy vitet e studimit prej 3000 orësh përkthehet në 465 orë leksione, 375 orë seminare, 305 orë laborator dhe 1855 orë studimi individual, totali i të cilave përkon me 120 kredite ECTS. Viti akademik ndahet në dy semestra, 15 javë për semestrin e parë dhe 10 javë për të dytin. Në planin mësimor të programit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" parashikohen të gjitha lëndët të cilat zhvillohen gjatë secilit semester me kreditet dhe orët e ngarkesave përkatëse.</p> <p>Sipas Shtojcës "Tabelat Përmbledhëse" (tabelat 10), për Programin Mësimor 2020-2022, shpërndarja e ECTS është Sem. I me 31 kredite dhe Sem II me 29 kredite, Sem. III me 24 kredite dhe Sem. IV me 36 kredite (prej të cilave 15 i takojnë punës për Tezën e Diplomës).</p> <p>Sipas Shtojcës 3.9 "Planet mësimore 2020-2024, për Programin Mësimor 2022-2024, shpërndarja e ECTS ruhet e njëjtë si në Planin mësimor 2020-2022.</p> <p>Ndarja e lëndëve është me bazë kreditesh ku peshën kryesore e zënë lëndët e disiplinave karakterizuese dhe më pas ato të integruara. Planet mësimore janë hartuar duke u bazuar në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar. Ndarja e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi referuar veprimtarive formuese është nga A në E. Ndarja e krediteve ndërmjet lëndëve (Tipit të Veprimtarisë) varion nga 3 ECTS deri në 7 ECTS, pavarësisht kategorisë së lëndës.</p> <p>Për Planin Mësimor 2020-2022</p> <ul style="list-style-type: none">- Lëndët bazë (A) – 10.8% të krediteve (nga 15-20% që duhet të parashikohen);- Lëndët Karakterizuese (B) – 46.7% të krediteve (nga 50-55% që duhet të parashikohen);- Lëndët Ndërdisciplinore (C) – 20% të krediteve (nga 12-15% që duhet të parashikohen);



	<p>- Lëndët Plotësuese (D) – 10% të krediteve (nga 10-15% që duhet të parashikohen);</p> <p>- Detyrime Përmbyllëse (F) – 12.5% të krediteve (nga 3-5% që duhet të parashikohen).</p> <p>Për Planin Mësimor 2022-2024</p> <p>- Lëndët bazë (A) – 5% të krediteve (nga 15-20% që duhet të parashikohen);</p> <p>- Lëndët Karakterizuese (B) – 52.5% të krediteve (nga 50-55% që duhet të parashikohen);</p> <p>- Lëndët Ndërdisciplinore (C) – 20% të krediteve (nga 12-15% që duhet të parashikohen);</p> <p>- Lëndët Plotësuese (D) – 10% të krediteve (nga 10-15% që duhet të parashikohen);</p> <p>- Detyrime Përmbyllëse (F) – 12.5% të krediteve (nga 3-5% që duhet të parashikohen).</p> <p>Referuar të dhënavë sa më lart, Institucioni duhet të rishikojë programin për të përmbushur shpërndarjen e lëndëve sipas kërkesave të VKM-së.</p> <p>Evidenca 3.9. Planet mësimore të programit të studimit MSH Mbrojtje mjedisi 2020-2024.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Plani mësimor Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi Vitet akademike 2022-2024.</p> <p>Tabelat përmbledhëse, tabelat 9.1 dhe 10.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konstatohet se programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" synon të pajisë studentët me shprehje të një profesioni të caktuar. Objektivi i Programit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" është të krijojë specialistë në fusha të ndryshme mjedisore si administrim mjedisi, vlerësim dhe monitorim mjedisor, për tu punësuar më pas si specialistë mjedisi dhe inspektorë mjedisi në institucione shtetërore, biznese dhe agjenci të ndryshme.</p> <p>Programi dhe lëndët specifike janë në zbatim të Rregullores së Studimeve të FSHN, sipas së cilës "Programet e studimeve "Master i Shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar".</p> <p>Hartimi i programit është bazuar në studimin e tregut të punës dhe ndjekjen në vijimësi të punësimit të studentëve. Dinamika e këtij tregu kërkon një pozicionim proaktiv të vazhdueshëm të institucionit lidhur me specifikat e reja që shfaqen.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL.</p>

	<p>Evidenca 5.7. Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021 dhe 2021-2022.</p> <p>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe stafin Akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe bisedat gjatë vizitës në institucion, programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisë" ka të parashikuar praktika profesionale dhe realizimin e tezës së diplomës.</p> <p>Specifikisht në program janë parashikuar 105 orë (7 ECTS ose 5.8% të totalit të krediteve) në Sem II (Lënda Bioekologji) dhe 15 ECTS për punimin e Tezës së Diplomës (12.5% të totalit të krediteve).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion janë vizituar edhe laboratorët, në të cilët është referuar se studentët kanë mundësi të zhvillojnë eksperimentet e lidhura me punimin e diplomës.</p> <p>Evidenca 1.18. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Biologjisë (2020-2024).</p> <p>Evidenca 2.4. Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisë".</p> <p>Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të FSHN.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Plani mësimor Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisë Vitet akademike 2022-2024.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 10.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 përqind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 përqind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë, realizohen në përputhje me ligjin e</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur nga IAL për programin Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisë" dhe vizita në institucion GVJ konstaton se ky program koordinohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Biologjisë. Departamenti ka të përcaktuar Përgjegjësit e Grupeve</p>

<p>arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Mësimore-Kërkimore (GMK) dhe pedagogët kujdestarë për marrëdhëniet me studentin. Përgatitja dhe monitorimi i zbatimit të planeve mësimore ndiqet dhe mbikëqyr nga Zv/Dekani për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve.</p> <p>Organizimi i përgjegjësive konfirmohet si vijon, në bazë të Rregullores së UNIEL: Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë i Departamentit, i cili mbikëqyr edhe programet e studimit që ofron Departamenti. Departamenti ka dy Grupe Mësimore Kërkimore. Përgjegjësit e GMK organizojnë hartimin e kurrikulave sipas lëndëve, ndjekin zhvillimin e programeve dhe raportojnë tek Përgjegjësi i Departamentit për realizimin e programit mësimor çdo semestër. Staf i GML është i përfshirë në procesin mesimor dhe ndjekjen e detyrave sipas specifikimeve të dhëna në Planin Mësimor apo edhe detyrat për mbështetjen dhe mbarëvajtjen e punës me studentët.</p> <p>Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve gjenden në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore për organizmin e këtij niveli studimesh.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL. Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisore". Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 1 dhe 2 mbi stafin akademik dhe ngarkesën mësimore.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 përqind.</p>	<p>Plani Mësimor për këtë program studimi përfshin elementë të ngjashmërisë lidhur me kohëzgjatjen (2 vjeçare), kreditet dhe shpërndarjen e tyre (120 ECTS), lëndët dhe ndarjen e ngarkesës në auditor e jashtë saj për leksione, seminare, laboratore dhe praktika në terren. Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimit me drejtuesit dhe stafin akademik mbi përmbajtjen lëndore, konfirmohet se niveli i ngjashmërisë deri në 70% është i arritur. GVJ konfirmon se ka ngjashmëri krahasuar me programe të ngjashme në universitete të tjera të vendit.</p> <p>Për shkak të dinamikës në rishikimin e kurrikulës së lëndëve është e vështirë të vlerësohet ngjashmëria në përmbajtje përtej listës së lëndëve të zhvilluara. Kjo ngjashmëri lejon transferimin e studentëve ndërmjet universiteteve. Institucioni ka një komision në nivelin e Fakultetit (FSHN), i cili bën ekuivalentimin e lëndëve për studentët e ardhur nga universitete të tjera. Sipas Evidencës 1.31, GVJ konstanton 7 raste ekuivalentimi për studentë të veçantë, ku referohen lëndët dhe kreditet specifike të ekuivalentuara. Në dokumentacion, janë përfshirë dy propozime të njësisë bazë, bazuar në komisionet përkatëse, për Rektoratin e UNIEL për ekuivalentimin e lëndëve për çdo student.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.31. Ekuivalentimi i lëndëve nga komisioni i FSHN, programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisore".</p>



	Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit i takon nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Veprimtaria formuese e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" ka veprimtari të formimit bazë, veprimtari karakterizuese, disiplina integruese, veprimtari plotësuese dhe detyrime përmbyllese (Teza e Diplomës). Në EMS paraqitet kodifikimi për secilën lëndë të programit të studimit.			
	Evidenca 1.8. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".			
	Evidenca 1.9. Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi ofrohet vetëm nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi është i organizuar sipar kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Ai përmbush kriteret e vlerësimit lidhur me objektivat dhe qëllimin, organizimin dhe strukturën e Planit mësimor dhe të kurrikulave lëndore. GVJ sugjeron një shpërndarje më të drejtë të lëndëve sipas tipologjisë, duke ju referuar përqindjes që zënë lëndë të ndryshme në grupin e lëndëve të formimit bazë apo karakterizues (referuar % së krediteve për çdo grup kundrejt numrit total të krediteve). Gjithashtu mund të përmirësohet shpërndarja e orëve (e për rrjedhojë të krediteve) të lëndëve të caktuara, duke i dhënë një peshë më të madhe atyre lëndëve që i takojnë formimit bazë dhe atij karakterizues kundrejt lëndëve të tjera ndërdisiplinore apo plotësuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" ofrohet nga Departamenti i Biologjisë, njësi bazë mësimore-kërkimore përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Elbasanit. Universiteti i Elbasanit është i akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 49, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 6 vite dhe afat përfundimtar të vlefshmërisë së akreditimit datë 26.11.2026.

	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë ushtrojnë aktivitetin e tyre akademik dhe shkencor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin dhe rregulloren e UNIEL.</p> <p>Departamenti i Biologjisë është i organizuar sipas statutit dhe rregullores së UNIEL. Ai drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit përbërja e tij paraqitet si në vijim:</p> <p>- Viti akademik 2021-2022: 10 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., dhe 2 Dr.; 3 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., dhe 1 Dr.; dhe 4 personel Ndhmës Akademik.</p> <p>- Viti akademik 2022-2023: 10 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., dhe 2 Dr.; 3 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof. As. dhe 1 Dr.; dhe 4 personel Ndhmës Akademik.</p> <p>Duke qenë së në të dhënat e paraqitura nga IAL në tabelat 1 dhe 2 të paraqitura në tabelat përmbledhëse ka mospërputhje, GVJ, për pasqyrimin e të dhënave më lart, i është referuar tabelave 2.</p> <p>Për sa më lart, IAL përmbush kërkesat ligjore lidhur me organizimin dhe funksionimin e njësisë bazë, me të paktën 7 personel akademik efektiv, ku të paktën 3 të jenë me grada/tituj.</p> <p>Departamenti i Biologjisë është i organizuar në dy Grupe Mësimore-Kërkimore (GMK). Ai realizon aktivitetin mësimor në disa programe studimi: 2 Programe Studimi Bachelor, 1 Master Shkencor dhe 1 Program Studimi Diplome 2-vjeçare profesionale "Teknik Mjedisi".</p> <p>Bazuar në ngarkesën mësimore individuale të stafit akademik dhe raportimit gjatë vizitës në institucion, stafi akademik i këtij departamenti mbulon gjithashtu edhe procesin e mësimdhënies për lëndët e shkencave biologjike në departamente të tjera të FSHN si dhe në fakultete të tjera të UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL. Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.3. Strategjia e UNIEL. Evidenca 1.5. Urdhëri i hapjes UNIEL. Evidenca 1.6. Certifikata e Akreditimit Intitucional. Evidenca 1.18. Strategjia e zhvillimit të Dep. të Biologjise 2020-2024. Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 2 dhe 4.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni dhe vizita në institucion, në Dosjen e programit të studimit Master i Shkencave "Mbrojtje Mjedisi" (Evidenca 3.12) studentët kryejnë praktika laboratorike në laboratore të FSHN si dhe programi i tyre i studimit parashikon praktika në terren dhe në aktivitete të rëndësishme në aspektin e parametrave të mjedisit pranë institucioneve ose bizneseve private. Referuar tabelave 2 në tabelat përmbledhëse të marra si dokument gjatë vizitës, institucioni angazhon 4 personel akademik ndihmës me karakter</p>

<p>mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>mësimor në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies si dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>GVJ vlerëson se stafi ndihmës akademik ka kualifikimin dhe përvojën për të mbështetur realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, përfshirë edhe bibliotekën. Ky personel është i specializuar sipas grup-lëndëve ku edhe janë angazhuar. Ata ofrojnë mbështetje për realizimin e orëve laboratorike, sistemimin e materialeve didaktike, mirëmbajtjen e laboratorëve, konservimin e materialit biologjik, krjimin e bazës mësimore praktike, asistencë në praktikën në terren etj.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e UNIEL.</p> <p>Evidenca 2.4. Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021 – 2022.</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 4.3. Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të FSHN.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 2.</p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmohet se koordinatori i programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" është përgjegjësja e Departamentit, e cila koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimin në rolin e koordinatorit të programit dhe kujdeset për ruajtjen e cilësisë dhe mbarëvajtjes së zhvillimit të mësimin në programin e studimit. Detyrat përfshijnë lehtësimin, koordinimin, mbarëvajtjen e procesit, zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e objektivave të tij. Koordinatori i programit komunikon me departamentin ku raporton në lidhje me ecurinë e programit.</p> <p>Evidenca 1.24. Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë është e organizuar dhe funksionon në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore lidhur organizimin dhe funksionimin e këtij programit studimi si në numrin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, dhe në koordinimin dhe drejtimin e punës së njësisë. Në njësinë bazë është caktuar koordinatori i programit me detyra specifike.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="609 1588 799 1655">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="805 1588 975 1655">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="981 1588 1412 1655">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="609 1664 799 1700"></td> <td data-bbox="805 1664 975 1700"></td> <td data-bbox="981 1664 1412 1700" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni dhe vizita në Institucion konstatohet se Departamenti i Biologjisë, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi", disponon informacionet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e programit, me informacion përmbajtjen e programit, objektivat, elementët e tij, kontrollin e dijës, rregullat e studimit, diplomimit, etj (Evidenca 1.8); - Planin strategjik të programit të studimit, me drejtimet kryesore të zhvillimit të FSHN, Departamentit të Biologjisë dhe Programit të Studimit (Evidenca 1.17 dhe 1.18); - Program mësimor i ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi, me lëndët e ndara sipas kategorive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe ngarkesa mësimore sipas veprimtarive formuese të secilës lëndë (Evidenca 3.9); - Programet e çdo lënde ((Evidenca 3.12); - CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Biologjisë, CV-të e personelit akademik të departamenteve të tjera të FSHN apo fakulteteve të tjera të angazhuara në zhvillimin e planit mësimor të programit (Evidenca: Shtojca CV MSH); - Kuotat dhe kriteret e pranimit në program (Evidenca 1.21 dhe 1.22); - Formati dhe Suplementi i diplomë (Evidenca 3.7 dhe 3.8). <p>GVJ vlerëson se përmbajtja, struktura dhe organizimi i studimeve në programin Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi", janë në përputhje me legjislacionin dhe me aktet nënligjore në fuqi. Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmohet se ky informacion është i disponueshëm për studentët dhe bëhet i njohur përmes komunikimit dhe faqes së internetit. Konfirmohet se ndryshimet në programet lëndore, kriteret e pranimit, ngarkesa mësimore e pedagogëve propozohen dhe miratohen strukturave përgjegjëse të UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit MSH Evidenca 1.17. Strategjia e zhvillimit të punës në FSHN Evidenca 1.18. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Biologjisë 2020-2024 Evidenca 1.21. Vendim për miratimin e kuotave të pranimit MSH Mbrojtje Mjedisi Evidenca 1.22. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit MSH Mbrojtje Mjedisi Evidenca 3.7. Formati i diplomës MSH Mbrojtje Mjedisi Evidenca 3.8. Modeli i suplementit të diplomës MSH Mbrojtje Mjedisi Evidenca 3.9. Planet mësimore të programit të studimit MSH Mbrojtje Mjedisi 2020-2024 Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi". Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit MSH Mbrojtje Mjedisi 2020-2024.</p>
--	---

<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstanton se programi i studimit përmban planin mësimor sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Ai është i organizuar në lëndë dhe module, sipas semestrave në të dy vitet e studimit. Në planin mësimor përfshihen praktika mësimore dhe në terren si dhe aktivitete formuese. Ndarja e lëndëve dhe moduleve i përgjigjet këtyre kategorive të përcaktuara. Lëndët dhe modulet janë të shpërndarë në dy semestra, me kredite të specifikuar qartë. Programi ka të përcaktuar Leksionet, Seminare dhe Ushtrime, Laboratore, Praktika në terren. (Tabela 10)</p> <p>Evidenca 3.9. Planet mësimore të programit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" për vitet akademike 2019-2020, 2021-2023, 2022-2024.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 10.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstanton konfirmon se programi përmban informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca 1.2), jepen kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërsa kriteret specifike të pranimit propozohen nga Departamenti i Biologjisë, dhe miratohen nga strukturat e UNIEL (Dekanati i FSHN dhe Rektorati i UNIEL).</p> <p>GVJ konstaton se Programi i Studimit MSH Mbrojtje Mjedisi disponon dokumentacionin e nevojshëm për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël brenda UNIEL ose nga institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Ky proces kryhet nga njësi përgjegjëse, e cila ngre komisionin përkatës që propozon ekuivalentimin për çdo student, sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e UNIEL. Vendimi për transferim e miraton Dekani i FSHN.</p> <p>Nga vizita në institucion referohet se në programin e studimit nuk ka patur raste transferimi, por vetëm ekuivalentim të lëndëve të programit lëndor.</p> <p>Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve në universitetin pritës janë 30 dhe pranohen kandidatët me rezultatet më të larta.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.8. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi". Evidenca 1.22. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi". Evidenca 1.31. Ekuivalentimi i lëndëve nga komisioni i FSHN, programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi". Evidenca 5.1. Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me programin lëndor, GVJ konstanton se Programi i studimit përmban programet lëndore për secilën lëndë, përfshirë specifikimet për orët laboratorike dhe praktikën në terren. Struktura dhe informacionet e paraqitura në to janë në përputhje me formatin e miratuar (përfshirë përmbajtjen dhe shpërndarjen e temave, mënyrën e vlerësimit, dhe literaturën). Syllabuset përgatiten nga titullari i lëndës në miratohen në njësinë bazë.</p>

<p>auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Çdo program lënde përmban literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Në disa raste literature e detyruar paraqitet si “Leksioni të përgatitura nga pedagogu”, ndërsa literatura e rekomanduar përmban burime në shqip dhe të huaja. GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës. Për literaturën e rekomanduar të referohen edhe faqet e internetit ku mund të aksesohet ose biblioteka e UNIEL.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca shtojca. Syllabus MSH Mbrojtje Mjedisit.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ konstanton se bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe informacionin e marë gjatë vizitës në institucion se Departamenti i Biologjisë shqyrton dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme Programin e Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit" në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Referohet se ndryshimet e programit kanë qenë deri në masën 20%, krahasuar me vitin e mëparshëm akademik dhe pas miratimit në Senat janë përcjellë për miratim në MASR. Konstatohet se ndryshimet lidhen me këmbim lëndësh midis semestrave, zhvendosje të lëndëve në vite dhe ndryshim në ngarkesën mësimore.</p> <p>Referohet se çdo vit kryhet rishikimi i sillabuseve për të gjitha ciklet e studimit, përmbajtja e tyre, literatura (tekste mësimore, materiale të tjera, mënyra se si zhvillohet mësimi - leksione, laboratore/seminare, praktika etj.) duke marrë parasysh edhe sugjerimet e studentëve të mbledhura në procesin e vlerësimit të lëndëve në fundin e vitit akademik.</p> <p>Bazuar në Tabelën përmbledhëse 11, specifikohen ndryshimet e ndodhura në vite të ndryshme për lëndë specifike të cilat evidentojnë përmirësimet dhe plotësimet përmbajtësore të lëndës. Këto ndryshime përmbajnë shtim lëndësh të reja apo ndryshime në ngarkesën e komponenteve të lëndës (Leksione, Laboratore apo praktika në terren). Në Evidencat 1.28 dhe 1.29 (Raportet vjetore të punës për dy vite) referojnë ndryshimet e krediteve dhe lëvizje të lëndëve ndërmjet semestrave.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 1.28. Raport i punës mësimore dhe kërkimore për vitin 2020-2021</p> <p>Evidenca 1.29: Raport i punës mësimore dhe kërkimore për vitin 2019-2020.</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 11, Ndryshimet e përgjatë viteve në programin e studimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se dokumentacioni i nevojshëm lidhur me organizimin dhe strukturën e programit është i plotë. Ai referohet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Përmirësimet përmbajtësore dhe të strukturës së programit në vite, sikundërse referohen deri në masën 20%,</i></p>

	<i>kryesisht kanë të bëjnë me ndryshime të strukturës dhe shpërndarjes së lëndëve.</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur dhe shqyrtuar nga GVJ përmban informacion rreth programit të studimit Master i Shkencave "Mbrojtje Mjedisit", i cili mundëson mësimin në auditor (leksione, seminare dhe kontrolli i vazhdueshëm) përmes një sërë aktiviteteve.</p> <p>Takimet gjatë vizitës në institucion, në takimet me grupin përfaqësues të studentëve dhe me stafin akademik, konfirmohet ndërveprimi student pedagog për të zhvilluar aftësi të reja dhe nxitur mendimin kritik për çështje të lidhura me mjedisin. Referohet se ky ndërveprim kryhet gjatë procesit mësimor (seminare, konsultime) dhe jashtë tij (bazuar në interesimin e studentëve).</p> <p>Studentët konfirmojnë se ka mundësi punësimi në bizneset private bazuar në njohuritë e fituara gjatë ndjekjes së këtij programi. GVJ konstaton se programi i studimit ndihmon studentët të punësohen kryesisht në tregun rajonal të punësimin, ndonëse mundësitë janë ende të kufizuara dhe luhatje të shpeshta.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 5.7. Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022.</p> <p>Evidenca 5.18. Të dhëna rreth punësimin të studentëve që kanë ndjekur studimet në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 21 dhe 23.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në shqyrtimin e Evidencës 3.12 mbi Programin e Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit", dhe sylabuset lëndore se kurrikula ju mundëson studentëve njohuri dhe aftësi në fushën e mjedisit. Në tërësinë ë tij program, mundëson arritjen e objektivit të formimit të specialistëve të rinj mjedisore, kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>Sipas dosjes së programit dhe ndryshime të bëra përgjatë viteve, studentët kanë mundësi të fitojnë shprehi dhe aftësi të kërkimit shkencor dhe zbatimit në praktikë të teknikave të matjes së treguesve mjedisorë (biodiversitet, ndotje e ajrit, ujë tokës, etj).</p>

	<p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi"</p> <p>Evidenca 5.20. Të dhëna të punësimit të studentëve që kanë ndjekur studimet në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 10 dhe 11.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" ka të përfshirë punë në laborator dhe praktika në terren. Modulet e ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Natyra e këtyre praktikave synon të përmbushet bazuar në ofertën prej kompanive private në zonën përreth apo edhe të institucioneve dhe agjencive që punojnë në fushën e mjedisit të pranishme në këtë rajon si ADZM.</p> <p>GVJ vëren se thellimi i praktikës në elemente specifike të lidhura me tregun e punës do të ndihmojë studentët për tu afruar me tregun e punës. UNIEL ka paraqitur evidencë për marrëveshje të lidhura me operatorë lokalë për të thelluar kompetencat profesionale. Gjatë vizitës në institucion janë referuar disa bashkëpunime me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan (lidhur me Parkun e Shebenikut), apo me operatorët turistike si Elite Travel Elbasan. Këto janë shtrirë në vizitat e studentëve në terren apo të operatorëve në mjediset e UNIEL, për të krijuar mundësi dhe kontakte që ndihmojnë punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Evidenca 2.4. Të dhëna mbi ekspeditat e studentëve.</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.24. Marrveshje e UNIEL dhe FSHN me Administratën e Zonave të Mbrojtura.</p> <p>Evidenca 5.7. Të dhëna mbi punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ku vëren se ndarja e veprimtarive formuese paraqitet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në sillabuset e lëndëve dhe moduleve. Praktika në laborator apo terren zë një pjesë të ngarkesës për ti krijuar mundësi studentëve për një formim të plotë profesional. Megjithatë, GVJ konstaton se ka mospërputhje lidhur me shpërndarjen e lëndëve sipas kërkesave të VKM 41, të ndryshuar, të cilat ndonëse nuk çenojnë arritjen e objektivave të përgjithshme të programit, duhen rishikuar prej institucionit që të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Përmes evidencës 3.7 dhe 3.8, GVJ konfirmon se diploma që jepet në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" shoqërohet me suplementin e diplomës. Dokumentacioni paraqet mundësitë e studentëve për mobilitet dhe transferrimin e studimeve duke ekuivalentuar pjesërisht apo programe të plota të studimeve.</p>

	<p>Evidenca 1.31. Ekuivalentimi i lëndëve nga komisioni i FSHN, program i studimit master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.5. Manuali i punimit të diplomës.</p> <p>Evidenca 3.7. Formati i diplomës MSH Mbrojtje Mjedisi.</p> <p>Evidenca 3.8. Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit MSH në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës: Tabelat përmbledhëse, tabelat 3, 20 dhe 23.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se Departamenti i Biologjisë analizon dhe paraqet propozimet çdo vit për mirësimin e programit të studimit, kryesisht lidhur me sillabuseve dhe shpërndarjen e ngarkesës sipas moduleve. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion të plotë lidhur me përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e frekuentimit, kontrollit, dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p>Çdo program lënde përmban literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Në disa raste literature e detyruar paraqitet si “Leksioni të përgatitura nga pedagogu”, ndërsa literatura e rekomanduar përmban burime në shqip dhe të huaja.</p> <p>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës.</p> <p>Për literaturën e rekomanduar të referohen edhe faqet e internetit ku mund të aksesohet ose biblioteka e UNIEL. Sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve.</p> <p>GVJ vëren se ndryshimet në sillabuset dhe programet e lëndëve kanë qenë deri në masën 20% dhe kryesisht të lidhura me shpërndarjen e krediteve dhe lëndëve gjatë semestrave. Dinamika e zhvillimeve në këtë fushë GVJ sugjeron një reflektim më të shpeshtë të këtyre ndryshimeve edhe në përmbajtjen e tematikave të lëndëve të këtij program dhe në literaturën e përdorur.</p> <p>Evidenca 1.28. Raporti i punës mësimore.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura, GVJ vëren se organizimi i programit të studimit, lëndet e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Bazuar në shqyrtimin e Evidencës 3.12 mbi Programin e Studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, dhe sillabuset lëndore se kurrikula ju mundëson studentëve njohuri dhe aftësi në fushën e mjedisit. Në tërësinë e tij programi, mundëson arritjen e objektivit të formimit të specialistëve</p>

	<p>të rinj mjedisore, kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit, fitojnë shprehi dhe aftësi të kërkimit shkencor dhe zbatimit në praktikë të teknikave të matjes së treguesve mjedisorë (biodiversitet, ndotje e ajrit, ujit tokës, etj).</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në programin Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit", studentët fitojnë njohuri të thelluara teorike me aftësi praktike, me aftësi për kërkim shkencor. Ata mundësohen për të vijuar më tej studimet e thelluara në programin e ciklit të tretë të studimeve dhe/ose punësimin në tregun e punës. Gjatë vizitës në institucion janë referuar disa bashkëpunime me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan (lidhur me Parkun e Shebenikut), apo me operatorët turistike si Elite Travel Elbasan. Këto janë shtrirë në vizitat e studentëve në terren apo të operatorëve në mjediset e UNIEL, për të krijuar mundësi dhe kontakte që ndihmojnë punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve. Vizita në institucion konfirmon se mundësohet punësimi në sektorin publik e privat dhe në institucione të vetqeverisjes lokale apo të menaxhimit mjedisor.</p> <p>Evidenca 1.24. Planifikimi i praktikave Bioekologji dhe Mikrobiologji Mjedisore.</p> <p>Evidenca 2.5. Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022.</p> <p>Evidenca 5.20. Të dhëna rreth punësimin të studentëve që kanë ndjekur studimet në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 23.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit përmban lëndë që sigurojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve duke ju mundësuar atyre transferimin, thellimin e studimeve apo dhe punësimin në sektorin privat apo publik, kryesisht në nivel rajonal.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se ka mospërputhje lidhur me shpërndarjen e lëndëve sipas kërkesave të VKM 41, të ndryshuar, të cilat ndonjëse nuk çënojnë arritjen e objektivave të përgjithshme të programit, duhen rishikuar prej institucionit që të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës, si dhe sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve.</i></p> <p><i>Bazuar në dinamikën e tregut të punës dhe e zhvillimit të njohurive në fushën e menaxhimit mjedisor sugjerohet që njësia bazë të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme këto zhvillime duke i reflektuar ato në përmbajtjen e lëndëve dhe raportin teori praktikë të realizuar përgjatë çdo semestri.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjerë në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ kontanton se përpjekjet për përmirësimin e programit të studimit janë kryer në kuadër të bashkëpunimeve me institucione brenda dhe jashtë vendit, të aktiviteteve trajnuese, etj. Institucioni ka disa bashkëpunime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca 3.1 referon se UNIEL dhe Departamenti i Biologjisë, për periudhën 2019-2023 ka nënshkruar marrëveshje, në kuadër të programit Erasmus+ duke vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me disa universitete homologe jashtë vendit. Në kuadër të këtij programi, personeli akademik është përfshirë në disa mobilitete të personelit akademik (Evidenca 3.2). Gjatë takimeve me stafin akademik në institucion referohet se në kuadër të bashkëpunimeve të shkëmbimeve Erasmus dhe Fulbright, Departamenti i Biologjisë ka pritur kërkues nga disa universitete evropiane. Në takimin me stafin akademik u referua se shkëmbime të tilla kanë qenë nxitje për ndryshime në programet lëndore apo pasurim i informacionit të dhënë në lëndë specifike dhe tematika të ndryshme. Ato kanë nxitur në organizimin e aktiviteteve trajnuese dhe informuese për ndarjen e të dhënave më të fundit në çështje të veçanta (informacion mbi referimet e lektorëve të huaj në mjediset e UNIEL).</p> <p>Evidenca 1.10. Lista e trajnimit të studentëve. Evidenca 1.13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Evidenca 3.1. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+. Evidenca 3.2. Lista e mobiliteteve për stafin e FSHN.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon se UNIEL ka mekanizma për të nxitur dhe përfshirë në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët në strukturat e tyre. Gjatë takimit me studentët është referuar se ata pyeten lidhur me opinionin e tyre për ecurinë e programit. Bazuar në Evidencën 1.2 parashikohen procedura si: ngritja e grupeve të punës/komisioni i cili do të merret me zhvillimin e kurrikulave; në përbërje të komisioneve duhet të ketë edhe studentë nga Këshilli Studentor.</p> <p>Vizita në institucion konfirmon se studentët janë pyetur përmes përfaqësuesve të tyre apo edhe përmes pyetësorëve. Përfshirja e studentëve në përmirësimin e kurrikulës sugjerohet të jetë më e strukturuar dhe e vazhduar, duke vlerësuar edhe efektivitetin e programit për njohuritë e pritshme në tregun e punës.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL.</p>

	Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL. Evidenca 2.2. Rregullore e Këshillit Studentor.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Dokumentacioni i paraqitur prej institucionit dhe diskutimet gjatë vizitës në institucion konfirmojnë se UNIEL ka përditësuar dhe riorganizuar programet në përputhje me zhvillimet strategjike të vendit, dhe sidomos të rajonit. Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët u theksua se tregu i punës ka qenë një faktor ndikues shumë i fortë për të krijuar drejtime të reja apo ndryshuar përbërjen e programeve. Raportimi vjetor i punës mësimore dhe kërkimore shkencore (Evidenca 1.28 dhe 1.29) i paraqesin këto përpjekje. Tabela 11 paraqet ndryshimet në programin e studimit paraqesin duket shtuar lëndë të reja. Megjithatë, sugjerohet një veprim edhe më i thelluar lidhur me përmbajtjen e lëndëve dhe të programit në mënyrë që të krijojë hapësira më të gjera për punësimin e mëtijshëm në fusha të menaxhimit mjedisor si pjesë e industrisë dhe teknologjisë. Evidenca 1.28. Raporti i punës mësimore Evidenca 1.29. Raporti i punës kërkimore shkencore Evidenca 5.7. Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021, 2021-2022. Evidenca shpeshë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 11, ndryshimet e përgjatë viteve në programin e studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se stafi i njësive bazë përgjegjëse për këtë program ka bërë përpjekjet e duhura për të përmirësuar programet me një pjesëmarrje të gjerë, duke përfshirë jo vetëm aktorët e brendshëm si stafi akademik dhe studentët, por edhe segmente të komunitetit si sipërmarrës private, të cilët kanë interes për fuqi punëtore të kualifikuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Bazuar në Evidencat 1.3 dhe 1.7, GVJ vëren se UNIEL ka vizion të qartë për rolin në përgatitjen e specialistëve të rinj në këtë rajon të vendit tonë. Mbrojtja e mjedisit përcaktohet qartë si një drejtim kryesor për vendin dhe rajonin e Elbasanit dhe cilësohet si drejtim prioritar zhvillimi. Objektivat e programit shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë orientimin drejt përgatitjes së specialistëve mjedisorë të fokusuar në këtë rajon. Kjo është në të njëjtën linjë edhe me objektivat e tërë institucionit dhe planet strategjike për zhvillimin e tij. Bazuar në diskutimet gjatë vizitës në institucion, konfirmohet se se prioritet mbetet ndërlidhja e këtij program studimi me punësimin e studentëve në vende punësimi të lidhura me studimet e përfunduara.

	<p>Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.3. Strategjia e UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit të FSHN.</p> <p>Evidenca 1.17. Strategjia e zhvillimit të punës në FSHN.</p> <p>Evidenca 1.18. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Biologjisë 2020-2024.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmojnë se Programi i Studimit Master në “Mbrojtje Mjedisi” zhvillohet nën drejtimin e Departamentit të Biologjisë, njësi bazë mësimore-kërkimore përbërëse e Fakultetit të Shkencave, në Universitetin e Elbasanit. FSHN dhe Departamenti i Biologjisë. FSHN është një ndër 5 njësitë kryesore të UNIEL, e përbërë nga pesë departamente dhe një qendër kërkimore.</p> <p>GVJ konfirmon se Departamenti i Biologjisë përmbush detyrimet ligjore për hartimin e programit, të lëndëve dhe ndjek të gjithë veprimtarinë e punës dhe kërkimit shkencor të lidhur me këtë program studimi.</p> <p>Organizimi dhe funksionimi i njësisë bazë është në përputhje me detyrimet e shprehura në Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL</p> <p>Evidenca 1.3. Strategjia e UNIEL</p> <p>Evidenca 1.6. Çertifikata e Akreditimit Institucional.</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 6.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur (tabelat përmbledhëse) referon përbërjen e stafit akademik dhe ndihmës akademik, dhe angazhimin e tyre në punën mësimore dhe shkencore.</p> <p>Takimi në institucion me studentët konfirmon se studentët janë të përfshirë në punën kërkimore përmes angazhimit në temat e diplomës (drejtpërsëdrejti dhe individualisht). Ata janë aktivizuar dhe kanë marrë pjesë në Konferenca Shkencore Studentore (referohet një e tillë në prill 2022, organizuar nga UNIEL) si dhe aktivizime në programe specifike bazuar në Marrveshje Bashkëpunimi si ajo me AdZM Elbasan.</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi” ka kualifikimin dhe përvojën për të asistuar në realizimin e punës kërkimore dhe praktikës në laboratore.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.</p> <p>Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të fakultetit.</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 6.</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion konfirmojnë mbështetjen financiare për aktivitetet studimore, kërkimore e shkencore. Këto aktivitete lidhen me organizimin e ekspeditave studimore për studentët, organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në UNIEL, si dhe publikimi nga personeli akademik dhe studentët në revistën periodike Buletini Shkencor UNIEL, me referencë botimesh në Buletinin Shkencor 2020/2-46 dhe Buletinin Shkencor 2021 (49).</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) janë referuar ekspedita studentësh brenda vendit (dhe në një rast edhe jashtë tij, në vendet fqinje, të financuara nga UNIEL).</p> <p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses në përdorimin e librarive elektronike ku mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare. Studentët dhe personeli akademik kanë në dispozicion një fond të dedikuar të librave, në Bibliotekën e UNIEL.</p> <p>Fondi i buxhetit i shpenzuar specifikisht për këtë program studimi është i vështirë të vlerësohet.</p> <p>Evidenca 2.3. Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022.</p> <p>Evidenca 2.4. Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022 UNIEL, i cili përditësohet periodikisht.</p> <p>Evidenca 2.5. Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022.</p> <p>Evidenca 2.6. Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL.</p> <p>Evidenca 2.7. Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</p> <p>Evidenca 2.8. Fondi i Librit.</p> <p>Evidenca 3.19. Konferenca Ndërkombëtare ALBLAKES.</p>						
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se UNIEL e ka përmbushur këtë standard vlerësimi përmes vendosjes së objektivave të qarta dhe të lidhura me prioritetet e vendit dhe të zhvillimit të institucionit, duke alokuar burime njerëzore dhe financiare për realizimin e tij. Këto burime janë evidentuar përmes evidencave specifike si ngarkesa mësimore e stafit apo buxhetet në vite të ndryshme; si dhe janë konfirmuar gjatë vizitës në institucion.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni, njësia bazë që është Departamenti i Biologjisë është i organizuar në dy Grupe Mësimore dhe Kërkimore, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë akademike në bazë të grup lëndëve dhe drejtimeve të kërkimit shkencor.</p> <p>Raportet vjetore të punës (Evidenca 1.28 dhe 1.29) paraqesin diskutime të kryera në njësinë bazë për të mbështetur drejtimet e kërkimit shkencor. Evidenca lidhur me bashkëpunimet shkencore me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit paraqesin ndihmesën që njësia bazë jep për kryerjen e shkëmbimit me institucione të tjera.</p> <p>GVJ konstaton se gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) se njësia bazë ka fituar një projekt kërkimor të financuar nga AKKSHI me fokus tek biodiversiteti dhe Zonën e Mbrojtur Shebenik i referuar edhe në Evidencën 3.21.</p> <p>Evidenca 1.28. Raporti i punës mësimore.</p> <p>Evidenca 1.29. Raporti i punës kërkimore shkencore.</p>

	<p>Evidenca 3.21. Projekt kërkimor i financuar nga AKKSHI.</p> <p>Evidenca 5.18. Vendimi i FSHN për ngritjen e komisionit të përhershëm “Për garantimin e Standarteve të cilësisë dhe Programeve të Studimit”.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe diskutimit gjatë vizitës në institucion, njësia bazë ka një program shkencor të mbështetur nga AKKSHI si dhe ka organizuar punën për kërkimin shkencor të lidhur me hartimin e temave të diplomës.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) referohen përpjekje për të nxitur përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në kërkimin shkencor, përmes temave të diplomës apo referime shkencore në aktivitetet e organizuara në UNIEL.</p> <p>GVJ vëren se raporti i GVB nuk jep të dhëna dhe informacion të mjaftueshëm lidhur me përmbushjen e këtij kriteri. Përveç referimit të procedurës, ai duhet të ishte më i plotë dhe përshkruar për mënyrën sesi njësia bazë organizon punën e saj për mbështjen për personelin akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.24. Detyrat e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.29. Raporti i punës kërkimore shkencore.</p> <p>Evidenca 1.32. Raporti i veprimtarisë së programit të studimit Master Shkencore Mbrojtjes se Mjedisit 2020-2021.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur referon se FSHN të UNIEL ka ndërmarrë aktivitete në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe ka krijuar bashkëpunim me lektorë nga universitete të tjera të huaja. GVJ konstaton se stafit akademik dhe studentët kanë pasur shkëmbime në kuadër të programit Erasmus për stafin akademik dhe studentët (Evidenca 3.2). Mobiliteti dhe shkëmbimi është konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion (Takimi me studentët dhe stafin akademik).</p> <p>Referohet se FSHN dhe Departamenti kanë realizuar disa konferenca shkencore (Evidenca 3.19) me bashkëpunime ndërkombëtare, me lektorë e institucione në huaja ku janë përfshirë pedagogë e studentë si pjesë e grupit organizues dhe grupit shkencor të tyre. Gjatë vizitës në institucion është konfirmuar përfshirja e studentëve në konferencat shkencore të zhvilluara gjatë vitit 2022 (Takimi me studentët).</p> <p>Evidenca 3.2. Të dhëna për mobilitetin e personelit.</p> <p>Evidenca 3.19. Konferenca ndërkombëtare ALBLAKES 2, 3, 4 organizuar nga FSHN, Departamenti i Biologjisë.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ vëren se dokumentacioni i paraqitur për Programi Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit", konfirmim synimin e institucionit të formojë specialist mjedisi me njohuri të thelluara teorike me aftësi praktike, me aftësi për kërkim shkencor dhe i trajnon për profesionin.</p> <p>Evidencat për Dosjen e programit dhe sylabuset e lëndëve mbështesin informacionin për përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p>Studentët që përfundojnë studimet në këtë program punësohen kryesisht në sektorin publik e privat dhe administratën vendore (njësi të mjedisit</p>

	<p>apo të zonave të mbrojtura, bashki, etj). Komunikimi me studentët gjatë vizitës në institucion e konfirmon këtë tendencë.</p> <p>Ndjekja në vijimësi e punësimit përmes komunikimit përmes zyrës përkatëse duhet të synojë një kontakt më të plotë dhe të shtrirë në kohë për të vlerësuar më realisht dhe në kohë të shpejtë të ndryshimeve në tregun e punës.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 23.</p>						
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Nga vizita në institucion (takimi me drejtuesit dhe kordinatorin e programit) referohet se njësia bazë dhe UNIEL, bë përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar programin në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit. Gjatë vizitës në institucion është referuar organizimi i ditëve të hapura me praninë e operatorëve të ndryshëm të biznesit, të cilët vendosin kontakte me student dhe paraqesin nevojat e tyre për punësim.</p> <p>Njësia bazë nuk referon diplomimin e studentëve në ndonjë profesion të licensuar apo urdhër të veçantë.</p> <p>Evidenca 5.7. Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021, 2021-2022.</p>						
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Pavarësisht referencës që jepet në RGB për këtë kriter, program i studimit nuk diplomon studentë të lidhur me ndonjë profesion të rregulluar.</p> <p>Gjithashtu UNIEL nuk është institucion i referuar me ligj për të kryer licencim në ndonjë fushë të lidhur me këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi.</p> <p>Evidenca 5.7. Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021, 2021-2022.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson mbështetjen që ka dhënë institucioni për përfshirjen në programe kërkimore si për stafin akademik dhe studentët për të nxitur formimin e profesionistëve të fushës.</i></p> <p><i>Programi nuk diplomon studentë të lidhur me ndonjë profesion të rregulluar, dhe sugjerohet të rrisë ndërveprimin edhe me institucionet e tjera homologe brenda vendit që të nxisin rregullimin për "specialist mjedisi", që t'i japë më tej frymëmarrje punësimit të specialistëve të rinj.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dosjen e programit dhe syllabusët e lëndëve, GVJ vëren se mësimdhënia dhe transmetimi i njohurive në këtë program realizohet përmes formave të ndryshme si: leksione, seminarë, laboratore, detyra kursi, dhe praktika në terren, bazuar në strukturën e planit mësimor vjetor të aprovuar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) këto elemente, përfshirë përdorimin e teknikave digjitale u referuan nga stafi akademik dhe studentët. GVJ konstaton se mjetet dhe pajisjet mundësojnë këto forma gjatë vizitës në mjediset e institucionit.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL. Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL. Evidenca 3.9. Planet mësimore të programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi” për vitet akademike 2019-2020, 2021-2023, 2022-2024.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ diskutoi me përfaqësues të stafit akademik dhe studentët të cilët referuan se përdoren metoda alternative të mësimdhënies, bazuar në specifikat e lëndës që zhvillohet dhe aftësive të studentëve. Referohet se personeli akademik organizon orën mësimore duke alternuar aspektin teorik me atë praktik duke aktivizuar studentët me diskutimet e tyre (Evidenca 1.32). Studentët pjesëmarrës në takim referuan se kanë mundësi të marrin pjesë në konsultimet e përcaktuara nga personeli akademik për përvetësimin sa më mirë të njohurive të marra.</p> <p>Evidenca 1.32. Raport i veprimtarisë së Programit të Studimit. Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon pajisjen e mjediseve të zhvillimit të mësimin me teknologji digjitale. Shkëmbimet në kuadër të programit Erasmus kanë ndihmuar personelin akademik në aspektin didaktik dhe në përdorimin e një teknologjie që mundëson lehtësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga takimi me studentët GVJ konfirmon se UNIEL përmbush nevojat me pajisje dhe bazë materiale të nevojshme për zhvillim dhe përmirësimin cilësor të mësimdhënies. Vizita në mjediset laboratorike konfirmon pajisjen e tyre me mjete dhe pajisje për zhvillimin e orëve mësimore, kërkimore-shkencore, etj.</p> <p>Evidenca 3.1. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+. Evidenca 3.2. Të dhëna për mobilitetin e personelit akademik.</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Evidenca 3.16. Të dhëna teknike të “Laboratori i Studimeve Mjedisore”.</p> <p>GVJ ka shqyrtuar evidencat lidhur me kualifikimin e stafit akademik (CV të stafit akademik) dhe konfirmon se ai është i kualifikuar dhe me përvojë në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor, në përputhje me realizimin e objektivave në përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në fushën e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>Mundësitë e përfshirjes në mobilitete apo kërkimin shkencor mundëson rritjen e kompetencave të personelit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin akademik kishte të pranishëm edhe staf akademik të jashtëm, i cili konfirmoi për GVJ se edhe stafi akademik i jashtëm që ka qenë i përfshirë ka kualifikimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e këtij program studimi.</p> <p>Evidenca 3.11. Curriculum Vitae e stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca 4.5. Tabelë përmbledhëse për angazhimin e personelit akademik për vitin 2020-2021.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë vizitës në institucion (Takimi me studentët) se studentët janë pjesë integrale e vlerësimit lidhur me mësimdhënien. Janë përdorur instrumenta të ndryshëm kryesisht pyetësorë që lidhen me vlerësimin e studentëve dhe punës së departamentit. U referua nga studentët dhe stafi akademik se NJSBSC dhe Departamenti i Biologjisë kanë zhvilluar anketime me studentët rreth vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës apo mënyrës së të mësuarit.</p> <p>GVJ u informua se studentët kanë të drejtën e ankimit sipas rregullores përkatëse pranë Komisionit të përhershëm të mbrojtjes së studentëve në rastet kur kanë pretendime për notën, vlerësimin e nga pedagogu apo dhe rishikim të tezave të provimit etj.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN.</p> <p>Evidenca 5.17. Vendim i FSHN për ngritjen e komisionit të përhershëm për “Mbrojtjen Studentëve” në FSHN.</p> <p>Evidenca 5.18. Vendimi i FSHN për ngritjen e komisionit të përhershëm “Për garantimin e Standarteve të cilësisë dhe Programeve të Studimit”.</p> <p>Evidenca 6.3. Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022.</p> <p>Evidenca 6.6. Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në UNIEL 2021-2022.</p> <p>Evidenca 6.7. Pyetësori i Departamentit të Biologjisë me studentët e programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisore”.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin</p>	<p>GVJ evidentoi përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion (Takimi me kordinatorin e programit dhe stafin akademik) se UNIEL ka në përbërje të saj strukturë me funksion koordinimin institucional, kërkimin shkencor dhe projektet (Takimi me përfaqësuesit e kësaj njësie). Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personelit akademik.</p>

eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë ka në përgjegjësi dhe organizon aktivitete të ndryshme informuese dhe njohëse për programin Erasmus+, trajnime, panairë punësimi, etj. GVJ ka vizituar edhe Qendrën e të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLL Center), ngritur në kuadër të projektit TEAVET e mirëpajisur dhe në gjendje shërbimi për studentët.		
Konkluzione	GVJ vlerëson pajisjen e mjediseve të mësimdhënies me teknologji digjitale që mundëson dhënien e njohurive me teknika të reja. Bashkëpunimi në kuadër të programeve Erasmus ka mundësuar zhvillimin e institucionit dhe stafit akademik në këtë drejtim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se bazuar në evidencat e paraqitura, kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve në UNIEL, FSHN dhe Departamentit të Biologjisë. Bazuar në vizitën në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët), konfirmohet praktika se vlerësimi është me provime dhe i ndërmjetën. Provimet realizohen me shkrim dhe studentët njihen me rezultatin përmes shpalljes nga pedagogët dhe mund të shohin korrigjimin. GVJ konfirmon se UNIEL zbaton prej disa vitesh dhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF. Për stafin akademik që e përdor këtë sistem, opinioni i grumbulluar nga GVJ ishte pozitiv. Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 1.15. Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Biologjisë. Evidenca 3.4. Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE. Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	GVJ konfirmon përmes vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) dhe bisedës me studentët se në fillim të çdo semestri, sipas rregullores së FSHN dhe të Departamentit, titullari i lëndës bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, njih studentët me objektivat dhe temat kryesore të saj si dhe elementët e tjerë të sillabusit (format e kontrollit të dijes dhe frekuentimin, literaturën që do të përdoret etj.)

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>GVJ konfirmon se informacioni mbi programet lëndore është i afishuar në faqen e internetit të UNIEL.</p> <p>Gjithashtu, në takimin me drejtuesit e njësisë dhe stafin akademik konfirmohet se Departamenti i Biologjisë, në konsultë me stafin akademik përcakton dhe njofton konsultimet dhe orarin e provimeve.</p> <p>Bazuar në evidencën e programeve lëndore, GVJ konfirmon se modeli i vlerësimit me provim është i përcaktuar në silabuset lëndore.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN.</p> <p>Evidenca 1.15. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Biologjisë.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p> <p>Evidenca 3.13. Orari i konsultimeve me studentët e Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>						
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ ka konfirmuar përmes vizitës në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur (Rregullore e programit të studimit) se ka rregullore ku janë përcaktuar format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar student gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës Vlerësimi është i vazhduar dhe/ose provim përfundimtar.</p> <p>Studentët dhe pedagogët konfirmojnë se testimi i ndërmjetëm organizohet në javët e planifikuara të çdo semestri në përputhje me planifikimin e bërë në sillabusin e lëndës e në varësi të këtij të fundit. Studentët konfirmojnë se kanë detyra kursit dhe projekte që punohen individualisht ose në grup në varësi të lëndës.</p> <p>Sipas dokumentacionit, provimi përfundimtar organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Gjatë vizitës në institucion u referua se zbatohet kryesisht provimi me shkrim.</p> <p>GVJ konfirmon nga takimi me drejtuesit e njësisë se grafiku i provimeve hartohet nga Zv.Dekani dhe miratohet nga Dekani. Ai shpallet para fillimit të sezonit të provimeve. Në formën e vlerësimit përfundimtar përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 45.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN.</p> <p>Evidenca 1.15. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Biologjisë.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson përbushjen e standardit si në rregullimin e procesit të vlerësimit ashtu edhe në kryerjen e tij gjatë procesit mësimor me anë të vlerësimit të vazhduar apo atij përfundimtar.</i></p>						
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1659 798 1727">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="798 1659 1005 1727">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1005 1659 1197 1727">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="606 1727 798 1771"></td> <td data-bbox="798 1727 1005 1771"></td> <td data-bbox="1005 1727 1197 1771" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.3**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Departamenti i Biologjisë është njësi bazë përgjegjëse për procesin e monitorimit të vlerësimit. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë, ajo organizon dhe ndjek procesin e vlerësimit të dijeve që bëhet gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda/moduli duke respektuar përcaktimet ligjore dhe aktet rregullatore të UNIEL-së. Sistemi i vlerësimit të dijeve është me 10 nota, e paraqitur kjo dhe në programin lëndor sipas kualifikimit të pikëve të fituara. GVJ konfirmon nga takimi me studentët në institucion se pedagogu njofton studentët për vlerësimin në fillim të vitit të ri akademik.</p> <p>Studentët dhe pedagogët konfirmojnë se testimi i ndërmjetëm organizohen në javët e planifikuara të çdo semestri në përputhje me planifikimin e bërë në sillabusin e lëndës e në varësi të këtij të fundit. Studentët konfirmojnë se kanë detyra kursit dhe projekte që punohen individualisht ose në grup në varësi të lëndës.</p> <p>Gjatë vizitës (Takimi ne studentët) konfirmohet angazhimi i studentit me detyra të ndryshme që ndihmojnë pedagogun për një vlerësim sa më të saktë të njohurive të fituara.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 1.15. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Biologjisë. Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisit”.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konfirmon se UNIEL zbaton prej disa vitesh sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF.</p> <p>GVJ vëren se ky sistem elektronik vlerësimi ende nuk përdoret në këtë program studimi për të gjitha lëndët. Teza e provimit është e hartuar nga pedagogu me pyetje me alternativa ose shtjellim në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më korrekt.</p> <p>Në sistemin elektronik të UNIEL-së, hidhen rezultatet e vlerësimit përfundimtar, duke informuar studentët në kohë reale për rezultatet e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion studentët referojnë se njihen me notat edhe drejtpërdrejt nga pedagogët e lëndës.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 41. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 1.15. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Biologjisë. Evidenca 3.4. Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, konfirmohet se komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet për dijeni dekanatit të fakultetit dhe</p>

	<p>sekretarisë mësimore. Takimi me koordinatoren dhe stafin akademik konfirmon se komisioni i provimit ka 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa anëtari tjetër ka të njëjtin profil ose të përafërt me të parin.</p> <p>Tezat e provimit rinovohen çdo vit akademik dhe firmosen nga drejtuesi i njësisë bazë para zhvillimit të provimit.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ vëren se sylabuset përmbajnë informacionin mbi shpërndarjen e vlerësimit në atë të vazhdueshëm përmes seminareve dhe pjesëmarrjes dhe atij përfundimtar përmes provimit të lëndës.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 36. Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studim Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisë”.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ ka verifikuar dhe konfirmuar gjatë vizitës në institucion se ndodh mbështetja e studentëve gjatë procesit të vlerësimit të vazhduar të elementëve të një moduli/lënde si seminare, detyra e kursit/projekte, ku stafi akademik bën komente specifike së lëndës gjatë korrigjimit në fletore, në rrugë elektronike ose në komunikim të drejtpërdrejtë.</p> <p>Studentët kanë konfirmuar gjatë vizitës në institucion se ndihmohen në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive. Pas korrigjimit të provimeve, studentët kanë një periudhë ankimi pasi janë njohur me rezultatin e provimit bazuar në rregulloren e studimeve në FSHN.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL, neni 45. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 40. Evidenca 3.13. Orari i konsultimeve me studentët e Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisë”. Evidenca 6.5. Kodi i Etikës UNIEL.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur në trajtën e evidencave (Analiza e punës mësimore) konfirmon se Departamenti i Biologjisë dhe stafi akademik zbatojnë kriteret për realizimin e provimeve dhe detyrave sipas rregullores së UNIEL, FSHN, të Departamentit si dhe Kodin e Etikës, sidomos e lidhur me kopjimin në provime dhe detyra.</p> <p>GVJ vëren se nuk ka ndonjë mekanizëm kontrolli lidhur me plagjiaturën në punimet e studentëve. Ky element nuk është referuar edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 45. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 40. Evidenca 1.28. Analizë e punës mësimore në Departamentin e Biologjisë. Evidenca 6.5. Kodi i Etikës UNIEL.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura (Rregullore e Programit të Studimit), rezultatet e vlerësimit final që paraqesin kontrollin e dijeve dhe aftësive të studentit iu bëhen të ditur në sistemin elektronik EMS, në periudhën</p>



<p>kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>limit të 5 ditëve kalendarike nga data e zhvillimit të provimit. Sistemi EMS udhëhiqet nga disa parime që garantojnë konfidencialitetin e të dhënave personale.</p> <p>GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në njoftimin e rezultateve të provimit prej studentëve (Takimi me studentët dhe me stafin akademik).</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 45. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 40. Evidenca 4.12. Rregullorja EMS. Evidenca 6.5. Kodi i Etikës UNIEL.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është referuar se vlerësimet iu jepen studentëve direkt nga pedagogu i lëndës, dhe student mund të shohë vlerësimin dhe mund të ankimojë.</p> <p>Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistemin EMS, studenti ka të drejtë të ballafaqohet dhe të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve.</p> <p>Takimi me stafin akademik dhe studentët konfirmon se komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e provimit. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të proces-verbalit në sistem. Provimet përgjithësisht realizohen me shkrim (bazuar në informacionin nga vizita në institucion me studentët dhe stafin akademik).</p> <p>GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në njoftimin e rezultateve të provimit prej studentëve.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 45. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 40. Evidenca 1.15. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Biologjisë.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas evidencave të paraqitura dhe konfirmuar prej vizitës në institucion, praktika e ndjekur është që kur studenti mendon se janë shkelur rregullat proceduriale të zhvillimit të provimit, ai ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit duke iu drejtuar dekanatit.</p> <p>Evidencës 1.7 jep edhe procedurën e vlerësimit.</p> <p>Urdhëri sipas evidencës 5.10 përshkruan funksionimin e Komisionit të përhershëm për mbrojtjen e studentëve i cili vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Dekani i FSHN është autoriteti që mund të nxjerrë vendimin përfundimtar.</p> <p>Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që administrohet nga komisioni i përhershëm për mbrojtjen e studentëve.</p> <p>GVJ nuk ka marrë referime gjatë vizitës në institucion për problematika në ankimin e rezultateve të provimit prej studentëve.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL, neni 46. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN, neni 42.</p>

	Evidenca 5.10. Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL.		
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson së institucioni përmbush këtë standard për të gjitha kriteret e vendosura për organizimin, njoftimin dhe trajtimin e ankesave lidhur me vlerësimin e njohurive të studentit.</i></p> <p><i>GVJ vëren se nuk ka ndonjë mekanizëm kontrolli lidhur me plagjiaturën në punimet e studentëve, i cili duhet vlerësuar sidomos për temat dhe punimet përmblylëse në ciklin e studimeve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Programi i studimit dhe Programet lëndore) mbështesin vlerësimin se ky program synon pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe përgatitjen e specialistëve të mjedisit.</p> <p>Në mbështetje të kësaj, është organizimi i lëndëve në 5 kategori, nga A në E. Tematika e lëndëve është e specializuar në drejtime të veçanta mjedisi ku studentët mund të specializohen për drejtime të ndryshme të tregut të punës.</p> <p>Gjetjet nga vizita në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) konfirmojnë kombinimin e njohurive teorike me ato praktike.</p> <p>GVJ sugjeron se praktikat më të zgjatura jashtë universitetit në institucione dhe agjenci të fushës do të përforconin më tej këto njohuri dhe lidhnin studentin drejtpërdrejt me tregun e punës.</p> <p>Evidenca 3.9. Planet mësimore të programit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit" për vitet akademike 2019-2020, 2021 -2023, 2022-2024.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 3.12. Dosja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Evidenca 3.10) konfirmojnë se programi i studimit nxit zhvillimin e studentit përtej fushave të mirëfillta mjedisore përmes prezantimit të detyrave, projekteve, temave të diplomës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion studentët referuan përfshirjen në konferenca shkencore me punime individuale ose në grup, duke nxitur formimin me të gjerë human dhe social të tyre në drejtim të komunikimit dhe ndërlidhjes me fusha të tjera.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 3.22. Konferenca studentore në UNIEL.</p>

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orionton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Evidencat e paraqitura (Tabelat përmbledhese, tabela 11) dhe diskutimet gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik) konfirmojnë rishikimin e programeve lëndore dhe kurrikulës në mënyrë periodike. Ato hartohen nga pedagogu i lëndës në të cilën përfshihen aftësitë dhe kompetencat që ai kërkon të ndërtojë tek studimi.</p> <p>Rishikimi përmbajtësor i lëndëve, përveç shpërndarjes së krediteve dhe kryerjes së tyre në semestral të ndryshëm, është sugjeruar nga GVJ për të afruar më shumë kompetencat që fiton studenti me ato që kërkon tregu i punës. Studentët kanë konfirmuar se pedagogët orientojnë studentët në përmbushjen e këtyre kompetencave të synuara.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit"</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhese, tabela 11.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se përbërja e kurrikulës së programit të studimit sipas lëndëve dhe modulet që e përbëjnë atë është ndërtuar në mënyrë të tillë që tu japë studentëve kompetenca dhe aftësi që u përgjigjen kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Lëndët e programit janë të larmishme duke e bërë kurrikulën e programit të studimit të përshtatshme për të nxjerrë specialist mjedisi. Referohen se përdoren metoda të ndryshme në transmetimin e njohurive që kanë si synim zhvillimin njohës dhe profesional të studentëve. Këto metoda konsistojnë në nxitjen e bashkëpunimit, diskutimit, punës në grup si dhe në krijimin e bashkëpunimit ndërinstytucional profesional dhe edukativ.</p> <p>Vizita në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) konfirmon zhvillimin e praktikave dhe vizitave në institucione të ndryshme i jep mundësi studentëve të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve. Evidencat konfirmojnë se Departamenti i Biologjisë ka krijuar bashkëpunime me institucione të ndryshme për të rritur mobilitetin e studentëve në kuadër të programit Erasmus.</p> <p>Evidenca 1.19. Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 1.32. Raport mbi veprimtarinë e programit të studimit Master i Shkencave ë "Mbrojtje Mjedisit" për vitet 2020-2021, 2021-2022.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave ë "Mbrojtje Mjedisit".</p> <p>Evidenca 3.18. Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik në programin Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit" në vitet e fundit.</p> <p>Evidenca 3.21. Projekti kërkimor-shkencor i financuar nga AKSHI (Evidentimi e vlerësimi floristik i Parkut Kombëtar "Shebenik" si dhe ngritja e kapaciteteve bashkëpunuese me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura).</p> <p>Evidenca 3.24. Marrëveshja e UNIEL dhe FSHN me Administratën e Zonave të Mbrojtura.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) referohen aktivitete me studentë, kryesisht nga lektorë të huaj ose përfaqësues të institucioneve e kompanive të rajonit në formën e orëve të hapura mësimore. Disa nga këto takime janë organizuar në kuadër të shkëmbimeve të Programit Erasmus (Evidenca 3.1).</p> <p>Evidencat për këtë kriter referohen në evidencat vijuese: tabela 19 nuk referon vitet specifike të këtij kontributi shkencor dhe fushat e veçanta të botimeve. Tabela 22 paraqet 9 studentë të përfshirë në tre vitet e fundit në projekte dhe aktivitete shkencore të pedagogëve. Në të mungojnë projektet e kërkimit shkencor të përbashkët me institucione të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 3.1. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+. Evidenca 3.25. Orari i zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të huaj. Evidencë shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 19 dhe 22.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Takimi në institucion me stafin akademik konfirmon se UNIEL bën përpjekje për të mbështetur studime kërkimore nga studentët, kryesisht përmes temave të diplomës dhe përfshirjen në konferenca studentore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Buletini Shkencor i institucionit mundëson publikimin shkencor. Laboratorët shkencorë janë të pajisur me disa mjete bazë që mund të përdoren prej studentëve në punët laboratorike dhe të temave të diplomës.</p> <p>GJV sugjeron se kjo përfshirje mund të jetë më e gjerë dhe e plotë. Numri i projekteve shkencore në njësinë bazë të mbështetur nga AKKSHI ose institucione të tjera është i ulët (referohet vetëm një projekt) dhe buxheti i institucionit për kërkimin shkencor mbetet i ulët, pa një referencë të qartë sa është pjesa e buxhetit që shkon për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 2.5. Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022. Evidenca 2.6. Të dhëna mbi revistën periodike BULETINI UNIEL. Evidenca 3.16. Të dhëna teknike të "Laboratori i Studimeve Mjedisore". Evidenca 3.19. Konferenca Ndërkombëtare ALBLAKES 2, 3, 4 organizuar nga FSHN; takime me kompani akademike nga institucioni i universitetit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GJV vlerëson përpjekjen e njësisë bazë për të rritur kompetencat e studentëve që vijnë në këtë program studimi duke përdorur element të teknologjisë së informacionit dhe përfshirjen në punë shkencore dhe kërkimore. GJV vëren se puna e shkencore e studentëve duhet evidentuar edhe më tej në evidenca, si dhe lidhur me efektivitetin e përdorimit të laboratorëve apo bashkëpunimeve me institucione të tjera për të zhvilluar kërkim shkencor.</i></p> <p><i>GJV vlerëson se duhet përpjekja për gjenerimin e fondeve për kërkimin shkencor përmes aplikimeve në burime të ndryshme financimi dhe/ose ndarjen më të qartë të fondeve për këtë qëllim nga burime të brendshme</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Rregullorja e programit dhe dokumentacioni tjetër mbështetës konfirmojnë se institucioni ka një procedurë të qartë për të fituar diplomën për programin e këtij studimi. Çdo student duhet të ketë grumbulluar numrin e krediteve të përcaktuara për këtë program studimi. GVJ ka konfirmuar këtë praktikë edhe gjatë vizitës në institucion (Takimi në sekretarinë mësimore).</p> <p>Në fund të programit në ciklin e dytë të studimit Master i Shkencave studenti mbron punimin e diplomës, për të cilën ndiqet dhe mbështetet nga një pedagog i programit.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimi në institucion (Takimi me stafin akademik dhe studentët) se stafi akademik informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit. Ai informon studentët për udhëzime apo materiale të tjera lidhur me përgatitjen për realizimin e punës së diplomës.</p> <p>Evidenca 3.5 përshkruan mënyrën e përgatitjes dhe kriteret për punimin e diplomës. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës. Gjatë vizitës në institucion nuk janë referuar problematika nga studentët për këtë çështje.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 3.5. Manuali i punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit dhe vizitën në institucion (Takimi me koordinatoren e programit) konfirmohet se komisioni i diplomës propozohet nga Përgjegjësi i Departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Ky komision është i përbërë nga tre anëtarë të stafit akademik i cili është angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konfirmohet se temat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin ato, përcaktohen nga departamenti i Biologjisë. Studenti duhet të ndjekë manualin e punimit dhe formatin e diplomës. GVJ konfirmon nga takimi me stafin akademik se udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës sipas rregullores së FSHN. Punimi i diplomës bëhet në disa faza ku përfshihet edhe grumbullimi i të dhënave, anlaizimi dhe kërkimi i literaturës. Gjatë vizitës në institucion nuk janë referuar problematika nga studentët për këtë çështje.</p>

<p>punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 3.5. Manuali i punimit të diplomës. Evidenca 3.7. Formati i diplomës Master i Shkencave Në "Mbrojtje Mjedisi". Evidenca 3.13. Orari i konsultimeve me studentët e Master i Shkencave në "MbrojtjeMjedisi".</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Evidencat 3.16 dhe 3.17 dhe vizita në institucion konfirmojnë ekzistencën e laboratorëve në UNIEL që mbështesin studentët e programit të studimit në Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" me pajisjeve të nevojshme të vëna në dispozicion për kryerjen e studimeve. Në Departamentin e Biologjisë, krahas 6 laboratorëve të Biologjisë dhe 4 të Departamentit të Kimisë ku ushtrohet pjesa eksperimentale e programeve lëndore, është në funksion të kërkimit shkencor edhe Laboratori i Studimeve Mjedisore. Labororet janë kryesisht mësimorë, por mbështesin edhe punët e studentëve për temat diplome. Referohet se kur është e nevojshme studentët mund të përdorin edhe Labororë të tjerë si ai i Metalurgjisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmon se ekspedita e kryera janë kryesisht në fushën e programit mësimor.</p> <p>Evidenca 2.4. Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022. Evidenca 2.12. Pasqyrimi i gjendjes së librave në literaturën ndihmëse dhe shtesë për studentët. Evidenca 3.16. Të dhëna teknike të "Laboratori i Studimeve Mjedisore". Evidenca 3.17. Të dhëna teknike të "Labororit kërkimor-shkencor" në ish Metalurgji. Evidenca 5.14. Planifikimi i praktikave Bioekologji dhe Mikrobiologji Mjedisore.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Takimi në institucion me stafin akademik konfirmon se mbrojtja e punimit të diplomës bëhet para një komisioni prej 3 deri 5 anëtarësh, ku njëri është dhe oponent. Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës studentit vlerësohet me notë. Vlerësimi i punimit të diplomës pasqyrohet në proces-verbalin përkatës dhe në sistemin e menaxhimit të të dhënave.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullore e Studimeve UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN. Evidenca 5.19: Të dhënat për temat e diplomës në MSH Mbrojtje Mjedisi 2020-2022.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë</p>	<p>GVJ konfirmon se studentët që kanë pëmbushur të gjitha detyrimet e programit të këtij cikli studimi dhe detyrimet e tjera financiare ndaj institucionit përkatës pajisen me diplomë shoqëruar me suplementin e saj. Diploma e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" shoqërohet me listën e plotë të notave dhe me suplementin e saj.</p>

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Evidenca 1.7. Rregullore e Studimit e FSHN.</p> <p>Evidenca 1.26. Miratimi i formatit të diplomës së programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.7. Formatit i diplomës Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.8. Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi në sekretarinë mësimore), GVJ konfirmon se UNIEL ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të çdo studenti. Dhënia dhe marrja në dorëzim e dokumentave bëhet kundrejt firmave. Regjistrat dhe dosjet ruhen në sekretari dhe arkivë.</p> <p>Evidenca 3.6. Rregullore për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumentave në UNIEL.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek dhe përmbush procedurën përmblyllëse të studimeve si në aspektin organizativ ashtu edhe atë të dokumentacionit të dorëzuar studentit apo të arkivuar në institucion.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e	Nuk aplikohet për këtë program studimi

shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.			
Konkluzione	Nuk aplikohet për këtë program		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet dhe CV-të e paraqitura (Evidenca 3.11), personeli akademik me kohë të plotë e të pjesshme, i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi", përmbush kërkesat ligjore në fuqi, duke patur grada/tituj akademikë.</p> <p>Në vijim paraqiten të dhënat për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi për secilin vit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 19-20: 12 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 9 Prof. As., dhe 2 Dr., dhe 3 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr. dhe 1 Dr.; - Viti akademik 20-21: 10 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., dhe 2 Dr., dhe 3 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr. dhe 1 Dr.; - Viti akademik 21-22: 10 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., dhe 2 Dr., dhe 3 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr. dhe 1 Dr.; - Viti akademik 22-23: 10 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., dhe 2 Dr., dhe 3 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof. As. dhe 1 Dr. <p>Fushat e studimit janë konform fushës kërkimore të personelit akademik të përfshirë.</p> <p>Lidhur me titullarët e lëndëve, GVJ vëren se jo të gjithë anëtarët e personelit të përfshirë përmbushin kriteret:</p>

	<p>- për titullin a kategorisë Profesor. Në një rast (B.P) me titull Dr. është titlular në katër lëndë.</p> <p>- për numrin e lëndëve si titullar: P. N. është titullar në 12 lëndë të ndryshme.</p> <p>Evidenca 3.10. Programet lëndore të ciklit të dytë të studimit Masteri i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Evidenca 3.11. Curriculum Vitae e stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 6 dhe 7.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e përcjella nga IAL (tabelat 12.1, 12.2 dhe 12.3), mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2020-2021: 78.6% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 21.4% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK; - Viti akademik 2021-2022: 78.6% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 21.4% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK; - Viti akademik 2022-2023: 85.15% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 14.85% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK. <p>Për sa më lart, ngarkesa mësimore mbulohet të paktën 70% nga personeli akademik efektiv.</p> <p>Lidhur me ngarkesën e lëndëve, GVJ vëren se jo të gjithë anëtarët e personelit të përfshirë përmbushin kriteret e Udhëzimit 29/2018, i ndryshuar :</p> <ul style="list-style-type: none"> - për numrin e lëndëve si titullar: sikurse cituar edhe në kriterin më sipër, P. N është titullar në 12 lëndë të ndryshme (Evidencë: Silabuset e MSH Mbrojtje mjedisi); - për numrin e lëndëve: vërehet numër më i madh lëndësh se sa lejon udhëzimi në fjalë. Për vitin akademik 2022-2023, vërehen rastet e mëposhtme (Evidencë: Tabela Përmbledhëse/Tabela 4): - B.P – 12 lëndë në programe të ndryshme; - P.N – 12 lëndë në programe të ndryshme; - S.M – 10 lëndë në programe të ndryshme; - E.P – 7 lëndë në programe të ndryshme; - N.L – 8 lëndë në programe të ndryshme; - N.K – 9 lëndë në programe të ndryshme; - S.T – 10 lëndë në programe të ndryshme; - E.Gj – 11 lëndë në programe të ndryshme; - L.B – 8 lëndë në programe të ndryshme.
	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura (tabela 6.1) ngarkesa mësimore e këtij programi të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi" është ndarë midis anëtarëve efektivë të Departamentit të Biologjisë dhe Departamentit të Kimisë si dhe 3 anëtarëve me kontratë.</p>

	<p>Stafi akademik PAE përmbush kërkesat për ngarkesën e kryer në këtë program për të mbuluar më shumë së 70% të orëve të programit në auditor. Ngarkesa e tij realizohet edhe në programe të tjera brenda UNIEL (kryesisht në programe Bachelor dhe Master Profesional).</p> <p>Shqyrtimi i ngarkesës së përgjithshme për çdo lektor në këtë program (Evidencë: Tabelat përmbledhëse, tabela 4), tregon se ai është brenda kufijve të përcaktuar për mësimin në auditor si normativës së lidhur me titullin dhe orëve jashtë auditorit.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës në orë mësimore në total, për të gjitha programet e studimit, paraqitet një ngarkesë që varion nga 446 në 641 orë. Bazuar në specifikimet e Udhëzimit 29/2018, i ndryshuar (Kreu II, pika 1) për kategorinë Prof. ngarkesa prej 140 orë+200 orë shtesë (dhe +100 orë në raste të veçanta), Lektor 160+200 orë shtesë (dhe +100 orë në raste të veçanta) dukshëm tejkalohet për të gjithë PAE, por dukshëm për: B. P (581.5 orë nga 460 orë), P. N (531 orë nga 440 orë), S. M (572 orë nga 440 orë), N. Lami, N. Kallajxhiu, S. Turku, E. Gjeta.</p> <p>Ndërkohë, për lektorët e ftuar ajo është nën normativën e përcaktuar prej 150 orë (varion nga 50-138 orë).</p> <p>Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 2, 4, 6, 12.1, 12.2, 12.3.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura në formë tabelare (tabela 6.1 deri 6.4) dhe deklarimi në CV e stafit akademik tregojnë për qëndrueshmëri të stafit prej një periudhe të gjatë. Stafi akademik në programin studimor është me përvojë të gjatë në të njëjtin pozicion mësimdhënës.</p> <p>Përmes kontratave të punës, të verifikuara në institucion, UNIEL dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit për të gjithë periudhën e akreditimit.</p> <p>Evidenca 4.1. Listëpagesa e personelit për periudhën janar-qershor 2022. Evidenca 3.11. CV stafi Mbrojtje Mjedisit. Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 6.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 4.2, 4.3 dhe 4.4 për rregulloret e institucionit për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, UNIEL ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike në varësi të kërkesës e nevojës së departamentit.</p> <p>GVJ konfirmon nga vizita në institucion (Takim në zyrën e personelit) se kërkesa paraqitet nga Departamenti i Biologjisë si njësi bazë dhe miratohet në dekanat. Njoftimet publikohen në faqen e internetit të UNIEL me kërkesa specifike për nivelin e duhur të kualifikimit dhe sipas nevojës në programin e studimit.</p> <p>Konfirmohet se kriteret e përgjithshme janë nota mesatare e dy cikleve të studimit, profili i studimit. Ndërsa ato specifike janë grada dhe tituj akademik që ka fituar brenda dhe jashtë vendit, përvojën e punës, njohuri të gjuhëve të huaja, aktivitetin shkencor etj. Procedura e vlerësimit të kandidatëve është e përcaktuar në rregulloren e rekrutimit të personelit të ri. Komision i vlerësimit Ad Hoc bën vlerësimin me pikë në dy faza:</p>

	<p>vlerësimin e dosjes me dokumentacionin përkatës dhe intervista. Aplikuesit mund të ankimojnë pas shpalljes së rezultatit.</p> <p>Evidenca 4.2. Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL.</p> <p>Evidenca 4.3. Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca 4.4. Rregullore e rekrutimit të personelit administrative.</p> <p>Evidenca 4.17. Kriteret dhe vendimet për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Biologjisë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni (Tabela 2) konfirmohet se njësia bazë ka katër staf ndihmës akademik në mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimor. Tre prej tyre kanë kualifikimin MSc dhe njëri kualifikimin Bch. Ai mbështet realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion është vendosur kontakt edhe me personelin ndihmës akademik në labororet përkatëse.</p> <p>Evidenca shitesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 2.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Konfirmohet nga vizita në institucion (Takimi në zyrën e personelit) se UNIEL mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Çdo anëtar i stafit akademik apo ndihmës akademik, efektiv apo me kontratë, ka dosjen e tij me dokumentacionin e plotë. Të dhënat personale ruhen veçmas sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Evidenca 3.11. CV stafi Mbrojtje Mjedisi.</p> <p>Evidenca shitesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabelat 4 dhe 6.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është konfirmuar se njësia bazë, përmes marrëveshjeve në nivel institucional, ka marrëdhënie shkëmbimi dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë lokalë dhe rajonalë të cilët ndihmojnë studentët për rekrutimin dhe punësimin. Një sërë aktivitetesh mundësojnë lidhjen mes universitetit dhe këtyre aktorëve.</p> <p>Evidenca 1.14. Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</p> <p>Evidenca 4.6. Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022</p> <p>Evidenca shitesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 5.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi me stafin akademik dhe kordinatorin e programit) konfirmohet se studentët mbikëqyrën nga një personel akademik gjatë praktikave jashtë UNIEL. Në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara midis Institucioneve, studentëve u krijohen kushtet për kryerjen e praktikës në terren. Konfirmohet se personi përgjegjës i cili mbikëqyr praktikën mban komunikim me përfaqësuesit e institucionit</p>

detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	duke krijuar e realizuar lehtësim në krijimin e kushteve të kryerjes së praktikës. Gjatë vizitës në institucion janë referuar monitorimi i studentëve gjatë praktikës mësimore. Rekomandohet që ky proces të jetë më i strukturuar për të mundësuar një lidhje më të fortë dhe rritur ndërveprimin me aktorët pritës.								
Konkluzione	Evidenca 1.13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. <i>GVJ vlerëson se institucioni përmbush kriteret për staf të kualifikuar dhe mbështetës për programin. Ai ka bërë përpjekje të lavdërueshme për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional, të cilat duhet zgjeruar dhe fuqizuar më tej për të mundësuar një bazë më të gjerë punësimi për studentët e diplomuar.</i> <i>GVJ vëren se duhet të përmbushet kriteri për titullarët e kategorisë Profesor dhe numrin e lëndëve që mbulojnë si titullar.</i> <i>GVJ vëren se ngarkesa e stafit të përfshirë duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin 29, i ndryshuar, si për numrin e lëndëve që mbulon çdo PAE në semester dhe numrin e orëve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Evidenca 4.7 dhe 4.8 mbi infrastrukturën dhe mjediset e FSHN ku zhvillohet ky program studimi referon se mjediset e Departamentit të Biologjisë në FSHN janë në godinën qendrore. Studentët zhvillojnë mësim (leksione, seminare, laboratore) në mjediset të mjaftueshme. Përmbushen kërkesat për hapësirë për një student (2.5m2 hapësirë të disponueshme). Vizita në institucion konfirmon se godina është e pajisur edhe me mjete për ndriçim alternativ, ujë, internet, vende çlodhje e qëndrimi, projektorë, system mbrojtjeje nga zjari, shkallët e emergjencës, shërbim ndihme të shpejtë etj. FSHN dhe Departamenti i Biologjisë mirëmbahet dhe plotëson standardet për infrastrukturën. GVJ konfirmon se FSHN ka mjediset mësimore të nevojshme për auditore leksionesh, salla seminaresh, laboratore, zyra etj. për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisore". Evidenca 3.16 dhe vizita në institucion konfirmojnë se "Laboratori i Studimeve Mjedisore" përmbush të gjitha kriteret për të realizuar kërkimin shkencor nga ana e personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Evidenca 3.16. Të dhëna teknike të "Laboratori i Studimeve Mjedisore". Evidenca 4.7. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit. Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të FSHN.

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konfirmon prej vizitës në mjediset e FSHN se janë mjediset mësimore të nevojshme për salla leksionesh, seminaresh, laboratore, zyra etj. të pajisura me mjetet logjistike për të përdorur teknologjinë e informacionit si kompjutera, video-projektorë, lidhje interneti.</p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik e kanë konfirmuar cilësinë e mjediseve dhe kushteve për zhvillimin e mëimit dhe praktikave në laborator.</p> <p>Evidenca 4.7. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</p> <p>Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të FSHN</p> <p>Evidenca shitesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 17.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Konfirmohet nga vizita në mjediset e institucionit se Departamenti i Biologjisë disponon 7 laboratorë: Laboratori i Botanikës, Laboratori i Mikrobiologjisë, Laboratori i Biologjisë; Laboratori i Studimeve Mjedimore, Laboratori i Ekologjisë, Laboratori i Anatomisë, Laboratori i Metodologjisë së Mësimdhënies, të vendosur në dy kate të godinës së FSHN. GVJ vlerëson së sipërfaqet janë të mjaftueshme për grupet laboratorike dhe studentë që mund të punojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Departamenti disponon dhe dy preparatorë për zhvillimin e seancave laboratorike.</p> <p>GVJ vëren se janë të pajisur dhe me kushte të përshtatshme për realizimin e programit mësimor.</p> <p>Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të FSHN.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ ka vizituar edhe dy laboratorë të teknologjisë së informacionit. Ata janë të pajisur me linjë interneti për zhvillimin e mëimit online apo kërkim literature dhe shërbime të tjera IT.</p> <p>Nga takimi me sfatin akademik konfirmohet se personeli akademik në zyrat e tij është i pajisur me kompjutera personalë, internet e paisjet e nevojshme për punë e përgatitjen mësimore.</p> <p>Evidenca 4.9. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHN-së.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe</p>	<p>Evidencat për bashkëpunimin përmbajnë edhe detyrimet reciproke për të mundësuar kryerjen e praktikave mësimorë në mjediset të përshtatshme edhe kur kryhet jashtë mjediseve të UNIEL.</p> <p>Nga takimet me stafin akademik dhe studentët konfirmohet se praktikat janë kryer në mjediset e ADZM Elbasan, Bashkisë Elbasan, dhe ndonjë operatori privat. Gjatë vizitës në institucion është konfirmuar se nuk ka pasur problematika lidhur me këtë drejtim.</p> <p>Evidenca 1.14. Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</p> <p>Evidenca shitesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 5.</p>

ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se kushtet e IAL janë të favorshme për realizimin e një procesi mësimor cilësor dhe praktike mësimore dhe/ose shkencore për të thelluar njohuritë e marra në auditor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në sillabuset e lëndëve në MSH Mbrojtje Mjedisi, GVJ vëren se sillabuset përmbajnë literaturë bazë dhe të rekomanduar. Sugjerime specifike për këtë pikë janë dhënë edhe në Standardin II.4, Kriteri 5.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik është referuar se UNIEL ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, e cila ofrohet në formë fizike dhe digjitale gjë e cila garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisi".</p> <p>Studentët kanë mundësi të gjejnë literaturë në fondin e dedikuar të librave në bibliotekën e universitetit dhe të përdorin librarinë elektronike me anë të portalit të bibliotekës online ku mund të konsultohen me materiale të literaturës ndërkombëtare.</p> <p>GVJ rekomandon përdorimin më të gjerë prej studentëve të literaturës në sistemin digjital, për shkak të pamundësisë për të kryer porosi për marrjen e literaturës së printuar në kohë të shpejtë dhe me kosto të arsyeshme.</p> <p>Evidenca 2.7. Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library. Evidenca 2.8. Fondi i librit. Evidenca 2.9. Të dhënat për infrastrukturën e Bibliotekës. Evidenca 2.10. Blerjet e fundit të Bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në vijim të vlerësimit të GVJ dhënë në Standardin II.4 për literaturën e listuar në sillabuset e lëndëve, takimi me stafin akademik konfirmon se pedagogu i lëndës informon studentët mbi literaturën e nevojshme. Ai referon në Departament nevojat për literaturë më të fundit. Vizita në bibliotekën e UNIEL konfirmon përditësimet në fondin e kësaj biblioteke (Evidencë 2.10). GVJ e kishte të vështirë të vlerësonte shpenzimet buxhetore për literaturë për këtë program.</p> <p>Evidenca 2.10. Blerjet e fundit të Bibliotekës. Evidenca 2.11. Buxhetimi për pasurim të Bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion është verifikuar prania e burimeve të literaturës në institucion në mjediset e bibliotekës. GVJ konfirmon se UNIEL ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të</p>

<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>konsultohen me literaturën ndërkombëtare. Studentët mund të përdorin 3 salla leximi në bibliotekën e UNIEL, ashtu edhe bibliotekën online (e aksesueshme në çdo kohë). Frekuentimi i bibliotekës prej studentëve gjatë vizitës në mjediset e saj ishte minimal. Takimi me stafin akademik konfirmon se personeli akademik është i gatshëm të vendosë në dispozicion të studentëve çdo material të nevojshëm të parashikuar në programet lëndore përkatëse.</p> <p>Evidenca 2.7. Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library. Evidenca 2.8. Fondi i librit. Evidenca 4.11. Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës e UNIEL, ku u njoh se ajo është e pajisur me fond librash e tekstesh. Fondi i teksteve të lidhura me programin është i kufizuar (Evidenca 2.8) dhe që nuk reflekton tërësisht listën e literaturës së rekomanduar në sillabuset e lëndëve, ndonëse përdorimi i fondit fizik është i pakët. Institucioni ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale të literaturës ndërkombëtare. Fondi fizik mbetet i kufizuar dhe kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme, ndaj sugjerohet që fondi digjital të shihet me përparësi.</p> <p>Evidenca 2.7. Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library. Evidenca 2.8. Fondi i librit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimet me studentët se UNIEL ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisit" në bibliotekat online. Në takimin me përfaqësuesit e studentëve u referua përdorimin e burimeve online kur kërkohen nga pedagogët.</p> <p>Evidenca 2.7. Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library. Evidenca 2.8. Fondi i librit.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ ka vërejtur gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës së biblioteka e UNIEL është e pajisur me kompjutera dhe pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Së fundmi, ajo është duke iu nënshtruar procesit të digjitalizimit, nëpërmjet një projekti të bashkëfinancuar nga AKKSHI dhe UNIEL.</p> <p>Evidenca 4.10. Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e bibliotekës UNIEL.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Vizita në mjediset e bibliotekës dhe biseda me studentët konfirmon se biblioteka UNIEL, është e hapur në çdo ditë të javës përfshirë edhe të shtunën me orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre në oraret, përkatësisht nga e hëna në të premtë në orarin 8.00-19.00 dhe të shtunën në orarin 8.00-16.00.</p> <p>Evidenca 4.11. Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës UNIEL.</p>


<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>(shih vlerësimin në kriterin 1 të këtij standardi)</p> <p>Vizita në mjediset e bibliotekës konfirmoi se kryhet raportim mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit). Përditësimi është vjetor bazuar në informacionin nga stafi akademik.</p> <p>Punonjësit e bibliotekës konfirmojnë se pedagogët paraqesin kërkesat e tyre për fondin e librave me të cilat pasurohet në vijim.</p> <p>Evidenca 1.12. Analiza vjetore institucionale 2020-2021.</p> <p>Evidenca 2.9. Të dhënat për infrastrukturën e bibliotekës.</p> <p>Evidenca 2.12. Kërkesa të Departamentit të Biologjisë për pasurim e literaturës së bibliotekës për vitet 2021-2023.</p> <p>Evidenca 2.13. Pasqyrimi i gjendjes së librave në literature ndihmëse dhe shtesë për studentët.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se mjediset dhe shërbimet e ofruara për studentët lidhur me burimet e informacionit dhe bibliotekën janë të disponueshme dhe bëhet përpjekje për përditësimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon përdorimin më të gjerë prej studentëve të literaturës në sistemin digjital, për shkak të pamundësisë për të kryer porosi për marrjen e literaturës së printuar në kohë të shpejtë dhe me kosto të arsyeshme.</i></p> <p><i>Fondi i teksteve të lidhura me programin është i kufizuar dhe që nuk reflekton tërësisht listën e literaturës së rekomanduar në sillabuset e lëndëve, ndonëse përdorimi i fondit fizik është i pakët.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet specifikuar qartë literatura e detyruar lidhur me emërtimin e ciklit të leksioneve, autorin dhe vitin përkatës.</i></p> <p><i>Për literaturën e rekomanduar të referohen edhe faqet e internetit ku mund të aksesohet ose biblioteka e UNIEL. Sugjerohet që literatura e rekomanduar për disa lëndë, ku lista është mjaft e gjerë, të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në evidencën 4.12 dhe takimet në institucion (Takim me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore) GVJ konfirmon se UNIEL disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. EMS (Electronic Management System) është sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve, ku administrohet i</p>

	<p>gjithë informacioni lidhur nga fillimi i studimeve dhe deri në përfundim të tyre.</p> <p>Vizita në mjediset e sekretarisë mësimore e FSHN-së konfirmon se ajo menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve i cili gjendet në bazën e të dhënave dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria mësimore mban dhe arkivon në dosje dokumente me të dhënat për çdo student.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i UNIEL. Evidenca 1.7. Rregullore e studimit e FSHN-së. Evidenca 4.12. Rregullorja EMS.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (Takimi në DBNj) GVJ konfirmon se ka sistem të brendshëm që administron të dhënat, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ, i cili është i aksesueshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Standardeve dhe Kurrikulave. Gjithashtu, të dhënat për personelin dhe studentët janë të aksesueshme në platformën online (https://umel.edu.al/) dhe në sistemin EMS (https://uniel.ems.al) duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Studentët komunikojnë dhe informohen për vlerësimet përmes sistemit elektronik dhe emailit zyrtar të pedagogëve dhe studentëve.</p> <p>Evidenca 4.12. Rregulloja EMS. Evidenca 1.4. Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL. Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 17.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimet me stafin akademik dhe studentët se sistemi i menaxhimit EMS ka integruar platforma që mundësojnë regjistrimin e lëndëve të studentit, si dhe të dhëna mbi orarin mësimor, vlerësimet, tarifat e studimit etj. Personeli akademik referon se ka komunikim të vazhduar me studentët me anë të adresave elektronike institucionale.</p> <p>GVJ konfirmon prej informacionit të mbledhur nga studentët se platforma Microsoft Teams është përdorur për të dhënë leksionet, video dhe literatura të tjera përkatëse në funksion të zhvillimit të procesit mësimor, sidomos gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p>Evidenca 1.32. Raport mbi veprimtarinë e programit të studimit Master i Shkencave në "Mbrojtje Mjedisore" për vitet 2020-2021, 2021-2022. Evidenca 4.12. Rregullorja EMS. Evidenca 6.1. Guida e pedagogut, mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Evidenca 4.12 referon se sistemi i menaxhimit garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ si dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> <p>GVJ e ka të pamundur të vlerësojë efencën e punës së këtij sistemi për të parë në kohë reale ecurinë e proceseve. Për sistemin e vlerësimit ky akses është i mundur për studentët dhe pedagogët.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	

	Evidenca 4.12. Rregullorja EMS.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konfirmon se UNIEL publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme të cilat përditësohen vazhdimisht dhe janë të shkruajtura në gjuhën shqipe. GVJ ka verifikuar dhe konfirmon se informacioni gjendet në https://uniel.ems.al/school/program/56ee0a4d-3555-4217-b3b7-acb4014245b0.aspx			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka ndërtuar sistemin mbështetës për menaxhimin dhe komunikimin digjital të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentët, përmes së cilit shpërndahen informacione të ndryshme lidhur me procesin mësimor dhe vlerësimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ është njohur në takimin me koordinatorin e programit dhe drejtuesit e FSHN lidhur me procesin e buxhetimit në nivel institucioni dhe njësisë bazë. Bazuar në evidencën 2.3 institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e ciklit të plotë të studimit në programin e studimit Master i Shkencave në "Mbrotjtje Mjedisi". GVJ e ka të vështirë të vlerësojë buxhetimin në nivel programi për shkak të mënyrës së organizimit të buxhetit në nivel institucioni dhe njësisë bazë dhe jo të programeve të studimit. Evidenca 2.3. Miratim i buxhetimit 2021 dhe buxhetit 2022. Evidenca 4.16. Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi për programet e Departamentit të Biologjisë. Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 18.



52

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në evidencën 2.3, GVJ vëren se shpenzimet që mbulohen i takojnë pagave për burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online. GVJ vëren se të ardhurat kryesore janë nga buxheti i shtetit dhe ato të vetë institucionit (Tabela 18). Konfirmohet se deri me tani ky mbulim ka qenë i plotë nga të ardhurat e gjeneruara, me peshën më të madhë në pagat e personelit akademik dhe mbështetës.</p> <p>Evidenca 2.3. Miratim i buxhetimit 2021 dhe buxhetit 2022. Evidenca shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 18.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në evidencën e paraqitur, GVJ konfirmon se UNIEL i nënshtohet vazhdimisht auditit periodik të bazuar mbi dokumentacion.</p> <p>Evidenca 4.14. Raporti i auditit KLSH 2022.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, është diskutuar mbi procesin e buxhetimit në nivel njësie bazë, e cila kryhet çdo vit. Mbi bazën e ndarjes së të ardhurave, njësia bazë vlerëson nevojat të cilat përcillen më tej në nivel fakulteti dhe universiteti.</p> <p>Evidenca 2.3. Miratim i buxhetimit 2021 dhe buxhetit 2022.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar procesit të buxhetimit, (informacion prej takimit me koordinatorin e programit) deri më tani institucioni ka mundur të garantojë mbulimin financiar të nevojave edhe për këtë program studimi.</p> <p>Rekomandohet që për të garantuar një qëndrueshmëri më afatgjatë në kushtet e uljes së numrit të studentëve, të shihet mundësia e gjenerimit të të ardhura shtesë, përmes përfshirjes në veprimtari konkrete edhe të studentëve të këtij program studimi, ndonëse vërehen kufizime të konsiderueshme lidhur me tipologjinë e shërbimeve që mund të ofrohen.</p> <p>Evidenca 2.3. Miratim i buxhetimit 2021 dhe buxhetit 2022. Evidenca 4.15. Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se kërkohet një analizë financiare më e thelluar dhe e plotë në nivel programi. Nevojat financiare në nivelin e programit do të përcaktojnë edhe mundësitë e zhvillimit të tij në të ardhmen, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve, duke konsideruar apo jo zhvillimin e punëve kërkimore të caktuara apo zgjerimin e përfshirjes së studentëve në terren apo veprimtari konkrete.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se në përputhje me kriteret dhe infrastrukturën në dispozicion të programit të studimit përcaktohen kuotat për numrin maksimal të studentëve që do të ndjekin programin e studimit. Propozimi për këto kuota përgatitet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani. Pas miratimit nga Dekani kuota kalojnë në Senatit Akademik të UNIEL dhe me Vendim të Senatit Akademik kuota dërgohen në Ministrinë e Arsimit.</p> <p>Sipas RVB, kriteret për pranimin e studentëve në këtë program studimi janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës si njësi kryesore për ofrimin e këtij program studimi (Evidenca 1.7).</p> <p>Gjithashtu ky program studimi ka edhe rregulloren e tij që gjendet në dosjen e vetvlerësimit (Evidenca 1.8), ku përcaktohen detaje të mëtejshme lidhur me politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e studimeve. Për më tepër, edhe Evidenca 1.19 Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, ka të dhëna specifike mbi politikat dhe procedurat për studentët në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 1.7. Rregullore e Fakultetit. Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Msh Mbrojtje Mjedisi. Evidenca 1.19. Korniza konceptuale e programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të Dosjes së Vetëvlerësimit (evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; evidenca 1.8 Rregullorja e Programit të studimit; evidenca 1.19 – Korniza konceptuale e programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”) rezulton se institucioni ka politikat dhe procedurat e nevojshme për të garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.19. Korniza konceptuale e programit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.	<p>Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm shkruhet se Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Drejtoria e Standardeve dhe e Kurikulave ndjek dhe monitoron pranimet sipas kuotave për çdo program studimi në</p>

<p>Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Universitetin e Elbasanit. Neni 23 i Rregullores së programit të studimit, veç të tjerash përcaktohet që: <i>kriteret e veçanta miratohen nga Departamenti i Biologjisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në mënyrë të përvitshme.</i></p> <p>Nga takimi i GVJ me Drejtorinë e standarteve dhe Kurrikulave si dhe gjatë takimit me studentët, GVJ u informua se kriteret e veçanta për studentët që duan të ndjekin këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Biologjisë dhe janë vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nota mesatare mbi 7; - Kualifikime të ndryshme. <p>GVJ sugjeron plotësimin e kriterëve të veçanta nga Departamenti për studentët që do të ndjekin këtë program.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Msh Mbrojtje Mjedisi, neni 23</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe dokumenteve që lidhen me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, GVJ vlerëson se ato janë shkruar në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme. Të gjitha dokumentet e përmendura më sipër janë të aksesueshme nga publiku nëpërmjet faqes së internetit të UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullorja e programit të Studimit.</p> <p>Evidenca 1.19. Korniza konceptuale e programit Master Shkencor në “Mbrojtje Mjedisi”.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm dhe informacioneve të marra gjatë takimeve në institucion, vërehet se institucioni përpara çdo fillim viti akademik informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të këtij program studimi.</p> <p>Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi duhet të zgjerojë kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në këtë program.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Referuar RVB dhe Evidencës 5.1 të përmendur në këtë kriter, GVJ konstaton se në këtë evidencë nuk gjenden të dhëna për kriteret e veçanta të hartuara nga institucioni për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave apo shtresave të marginalizuara.</p> <p>Evidencë 5.1. Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Referuar RVB dhe Evidencës 5.1 të përmendur në këtë kriter, GVJ konstaton se në këtë evidencë nuk gjenden kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Duke qënë se mungojnë të dhënat për numrin e kuotave për vitin akademik actual 2022 – 2023, GVJ tek të dhënat për kuotat për vitin akademik 2021 – 2022 vëren se nuk ka kuota të parashikuara për kandidatët nga shtete të tjera.</p> <p>Evidencë 5.1. Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</p>

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një formular për ndihmë për studentët të cilët konsiderohen shtresë në nevojë. Formulari gjendet bashkëlidhur Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 40, datë 02.11.2021.		
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Institucioni duhet të tregojë më kujdes në hartimin e politikave dhe procedurave për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet mesazisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Sipas Rregullores së programit të studimit Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisi, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin përcaktohen në këtë rregullore. Studentët informohen rregullisht në fillim të çdo viti mësimor mbi këto kriteret dhe procedura. Rregullorje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik është e aksesueshme edhe online në faqen e UNIEL. Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisi.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ u informua nga GVB se në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, studentëve ju vjen në ndihmë Drejtoria e Kurikulave dhe Sigurimit të Cilësisë duke i asistuar dhe informuar ata mbi kriteret dhe procedurat që aplikohen në raste të tilla. Deri tani nuk ka patur ndonjë rast specifik për këtë problem. Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisi.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë parashikuar në Rregulloren e programit të studimit, neni 15 i saj. Sipas këtij neni kriteret dhe format e vlerësimit të studentëve përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës (syllabus) dhe i bëhen të ditur studentëve nga pedagogu i lëndës. Studentët vlerësohen për pjesmarrje në leksione, në seminare, në detyrat e kursit, etj. GVJ ju komunikua se pedagogët e lëndës e informojnë studentin mbi vlerësimin e dijeve që në javën e parë të fillimit të vitit akademik, në prezantimin e parë që bëjnë me ta. Gjatë takimit që zhvilloi GVJ në Institucion, studentët e konfirmuan se informohen rregullisht mbi kriteret dhe rezultatet e vlerësimit kryesisht nga pedagogët përkatës. Po ashtu, ata konfirmuan se funksionon një sistem online ku

	<p>mund të marrin informacion të saktë e të përditësuar për vlerësimet dhe përparimin akademik. Gjithashtu, sekretaria mësimore është në ndihmë të studentëve për ti ndihmuar për çdo problem që ato kanë në lidhje me vlerësimet e tyre dhe/ose me plotësimet e krediteve.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisit.</p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procedura e diplomimit dhe marrja e diplomës është përcaktuar në nenin 20 dhe nenin 21 të rregullores së programit të studimit, Studentët informohen imtësisht mbi këto procedura në fillim të vitit të dytë akademik nga pedagogët përgjegjës. Njëkohësisht, Drejtoria e Kurrikulës dhe Departamenti i Biologjisë janë gjithmonë të gatshëm të ndihmojnë studentët në lidhje me procedurën e punimit të diplomës dhe procesit të diplomimit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se për specifika të veçanta në lidhje me punimin e diplomës, studentët diskutojnë gjërësisht që në fillim të vitit të dytë të studimeve me pedagogun udhëheqës.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisit.</p>						
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me Shefen e Departamentit por edhe me stafin akademik, GVJ u informua se Universiteti i Elbasanit organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve për të ndjekur programet e studimit që ofron ky institucion, pjesë e të cilit është edhe programi Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisit. Me informimin e studentëve kandidatë merret edhe Zyra e Këshillimit të Karrirës dhe ALUMNI. Departamenti i Biologjisë është përfshirë gjatë ditëve të hapura informuese duke dhënë maksimumin për të promovuar programet që ofron ky Departament.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisit.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisit, i është vënë në dispozicion informacion i plotë e i hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet mesdhisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet mesdhisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet mesdhisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është përcaktuar gjerësisht në të gjithë bazën rregullative të paraqitur nga Institucioni në Dosjen e Vetëvlerësimit. Sipas informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për këto çështje që në fillim të vitit akademik. Këto informacione janë të aksesueshme edhe në faqen online të UNIEL.</p>



	<p>Evidenca 1.4. Rregullorja e funksionimit të UNIEL.</p> <p>Evidenca 1.8. Rregullorja e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.19. Korniza konceptuale e porgramit MSH në Mbrojtje Mjedisi.</p>						
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se të dhënat për lëndët/modulet, përmbajtjen e tyre, dhe veprimtaritë formuese, studentët i marrin nga disa drejtime në UNIEL, përfshirë Sekretarinë mësimore, sistemi EMS, pedagogët e lëndëve. Informacion i detajuar dhe i aksesueshëm gjendet edhe në faqen e internetit të UNIEL.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.</p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ ju komunikua gjatë vizitës në institucion se ekzistojnë disa mënyra të komunikimit me studentët për ti informuar ato me tregun e punës dhe me mundësitë e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Zyra e karrierës dhe ALUMNI informon studentët mbi mundësitë e punësimit pas përfundimit të këtij programi studimi. Studentët, pas përfundimit të këtyre studimeve mund të jenë edhe kandidatë të mundshëm për të ndjekur studiet e ciklit të tretë, Doktoraturë. Në dosjen e vetëvlerësimit gjendet edhe Evidenca 4.6, në të cilën jepen disa të dhëna me aktivitetet e kryera në rang institucional nga Bordi Këshillimor i Biznesit për vitin akademik 2021-2022. Sipas kësaj evidence janë kryer gjatë këtij viti akademik 9 (nëntë) aktivitete të ndryshme që mund ti ketë ardhur në ndihmë edhe studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 4.6. Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022.</p>						
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ u informua se në ambiente të dukshme dhe të frekuentuara nga studentët, gjenden të dhëna që lidhen me orarin mësimor, orarin e bibliotekës, vendin se ku do të zhvillohet leksioni apo seminari etj.</p> <p>Sipas RVB, këtë informacion studentët e marrin edhe nga sekretaria mësimore por edhe nga pedagogët e lëndës të cilat kanë marrdhënie shumë bashkëpunuese me studentët e këtij programi, çka u konfirmua edhe nga studentët.</p>						
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër i gjithë informacioni i nevojshëm dhe i domosdoshëm në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi, është i aksesueshëm nga studentët online nëpërmjet faqes së internetit të UNIEL dhe sistemit të menaxhimit të informacionit EMS.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet UNIEL ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit dhe në tabelat që shoqërojnë këtë dosje, shprehet se UNIEL ka statistika për numrin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi që nga koha e hapjes së këtij programi. Referuar tabelës 23 rezulton se numri total i të diplomuarve në këtë program studimit është 183, nga të cilët 68 janë punësuar në përputhje me diplomën që kanë studiuar dhe 9 janë punësuar jo në përputhje me këtë diplomë. Sipas RVB statistikave në lidhje me të diplomuarit i disponon Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Sipas rregjistrimit të diplomave në Sekretarinë mësimore, numri i studentëve të diplomuar gjatë katër viteve të fundit rezulton si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2019-2020 – 13 studentë të diplomuar; Viti akademik 2020-2021 – 4 studentë të diplomuar; Viti akademik 2021-2022 – 15 studentë të diplomuar; Viti akademik 2022-2023 – 8 studentë të diplomuar.</p> <p>Vlen të theksohet se numri i studentëve të diplomuar të paraqitur më lart sipas rregjistrimit të diplomave, jo domosdoshmërisht përfshin studentët që kanë filluar studimet dhe i kanë përfunduar në një afat kohor aq sa zgjat edhe programi i studimit (2 vite akademike). Në këtë numër mund të përfshihen dhe studentët që kanë filluar studimet edhe më përpara dhe për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të diplomohen në kohën e rregullt të zgjatjes së programit të studimeve.</p> <p>Evidencë shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 23.</p>												
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm por edhe në takimet që u realizuan në institucion, GVJ shprehet se Departamenti i Biologjisë së bashku me strukturat përkatëse në rang Universiteti, disponon të dhëna në lidhje me studentët e regjistruar, largimet apo transferimet, si dhe të dhëna në lidhje me studentët të cilët e përfundojnë ciklin akademik dhe diplomohen. Gjithashtu GVJ u informua se, Departamenti për çdo vit akademik përgatit një analizë të hollësishme në lidhje me programet e studimit që ofron, si ato të ciklit të parë, ato të ciklit të dytë por edhe diplomat profesionale 2 vjeçare.</p> <p>Referuar tabelës 21, për tre vitet e fundit të dhënat statistikore për programin Master Shkencor në “Mbrojtje Mjedisi”, janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="598 1736 1380 1921"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Nota mesatare në dalje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2022</td> <td>19</td> <td>6.2</td> <td>7.1</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>11</td> <td>6.1</td> <td>8.3</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare në hyrje	Nota mesatare në dalje	2019-2022	19	6.2	7.1	2020-2021	11	6.1	8.3
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare në hyrje	Nota mesatare në dalje										
2019-2022	19	6.2	7.1										
2020-2021	11	6.1	8.3										

	2021-2022	21	6.8	në ndjekje në vitin e II
	2022-2023	14	6.8	në ndjekje në vitin e I
	<p>Sipas rregjistrimit themeltar të Sekretarisë mësimore, të dhënat për studentët e regjistruar janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2019-2020 – 19 studentë të regjistruar - Viti akademik 2020-2021 – 10 studentë të regjistruar (1 i çrregjistruar) - Viti akademik 2021-2022 – 18 studentë të regjistruar - Viti akademik 2022-2023 – 16 studentë të regjistruar. <p>Gjithashtu GVJ pa edhe shkresën e QSHA me Nr 3321 prot, datë 20.12.2000, për numrin e matriculimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023 (16 studentë).</p> <p>Evidencë shtesë gjatë vizitës. Tabelat përmbledhëse, tabela 21.</p>			
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sipas RVB por edhe sipas asaj çka pohuan edhe Drejtuesi i Fakultetit dhe Drejtuesja e Departamentit, por edhe stafi i angazhuar për hartimin e RVB, të dhënat që kanë lidhje me studentët, menaxhohen nëpërmjet një sistemi të brendshëm nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë por edhe Drejtoria Ekonomike. Sigurisht që këto të dhëna disponohen nga Sekretaria mësimore e cila është në një kontakt të përditshëm me studentët. Të dhënat e studentëve mnxhohen nëpërmjet sistemit EMS. GVJ u informua nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm se sistemi online është funksional dhe përdoret nga studentët, të cilët informohen rregullisht për detyrimet dhe vleresimet e tyre sipas lëndëve të planit mësimor.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisë.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, Institucioni merr masat e nevojshme nëpërmjet kontrolleve periodike duke vlerësuar dhe parë gjëndien aktuale të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre mësimore.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisë.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në</p>	<p>Departamenti i Biologjisë ka hartuar raporte analitike për veprimtarinë e tij, për programet që ofron, për studentët që ndjekin këto programe, për stafin akademik në rang Departamenti, mobilitetin e stafit dhe të studentëve, botime në buletine dhe në revista shkencore, synimet dhe objektivat për vitet në vazhdim, etj, GVJ mendon se këto raporte janë</p>			

drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	produktive dhe e ndihmojnë Njësinë bazë për ecurinë e punës por edhe për marrjen e masave aty ku gjërat nuk funksionojnë ashtu siç duhet. Evidenca 1.28. Raporti i punës mësimore dhe shkencore të Departamentit të Biologjisë, 2020-2022.						
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se institucioni ka të dhëna që lidhen me studentët që në kohën e rregjistrimit të tyre në programon e studimit Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, në diplomimin e tyre por edhe të dhëna që lidhen me punësimin.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, studentët janë të përfshirë në diskutimet e ndryshme që kanë lidhje me aktivitetin akademik të të gjithë Universitetit. Studentët e UNIEL janë të përfshirë edhe në Senatit Akademik, në përputhje me aktet ligjore në fuqi por edhe me Statutin e UNIEL. Sipas Evidencës 2.1 në të cilën është paraqitur lista emërore e Senatit akademik të UNIEL, vërehet se nga 23 anëtarë, dy prej tyre janë studentë. Në Universitetin e Elbasanit funksionon edhe Këshilli Studentor sipas rregullores së tij. Evidencë 2.1. Lista emërore e Senatit Akadeimk të UNIEL. Evidenca 2.2. Rregullore e Këshillit Studentor.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ u informua se përfshirja e studentëve në jetën institucionale të UNIEL është fakt. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik, janë pjesë e aktiviteteve të ndryshme kërkimore të pedagogëve të tyre dhe sigurisht janë pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të ndryshme që organizohen si në rang Insitucioni, ashtu edhe në rang fakulteti. Një pjesë e rëndësishme e përfshirjes së studentëve është edhe pjesëmarrja e tyre në procesin e vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit të programit ku ato studiojnë, Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisi. GVJ ju tha gjithashtu se rrahja e mendimeve dhe diskutimet e ndryshme në lidhje me këtë proces ishin një ndihmë e madhe për të gjithë grupin e punës për vetëvlerësimin e programit. Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin	Në takimin që patëm me Dekanin e Fakultetit dhe me përgjegjësen e Departamentit, GVJ u informua se përfshirja e studentëve në diskutimet e ndryshme që kanë të bëjnë me programin e studimit është evidente. Pyetësorët që shpërndahen nga zyra e NJSBC ishin një ndihmesë për Departamentin në lidhje me atë çka sugjeronin studentët nëpërmjet këtyre

e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	pyetësorëve për sa i përket si marrëdhënes me stafin akademik efektiv apo të jashtëm por edhe me mënyrën e funksionimit të programit mësimor.		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësish/pedagogut përgjegjës.	Duke shqyrtuar bazën rregullative si të Universitetit ashtu edhe të programit të studimit, vërehet se studentëve ju mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, por edhe mosrënia dakord dhe ankimi në lidhje me vlerësimet e kontrollit të dijeve. Gjithashtu studentët kanë mundësi të ankohen kur dicka nuk funksionon siç duhet në marrëdhënien pedagog –student, apo staf administrativ – student.		
	Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.		
	Evidenca 1.4. Rregullorja e funksionimit të UNIEL.		
	Evidenca 1.8. Rregullorja e programit të studimit.		
Konkluzione	GVJ shprehet se studentët janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të Institucionit dhe zëri i tyre ndëgjohet si nga Fakulteti ashtu edhe Departamenti i Biologjisë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ u informua nga disa drejtime gjatë vizitës në UNIEL se këtu funksionojnë disa zyra dhe struktura që janë në shërbim të informimit të studentëve. Informacioni i parë studentëve u jepet në Sekretarinë Mësimore, e cila është gjatë gjithë kohës në shërbim të tyre për çdo pyetje apo paqartësi që kanë. Përdormi i sistemit EMS ka vitë që ndihmon informimin në kohë të studentëve. Në ndihmë të tyre janë edhe Drejtorja e Kurikulës, Sigurimit të Cilësisë dhe Statistikës; Zyra e Këshillimit të Karierrës; Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë; Departamenti i Biologjisë; si dhe i gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi EMS është një sistem i cili është i ngritur prej disa vitesh në UNIEL, i cili është në shërbim të studentëve nëpërmjet informimit të tyre për gjithçka që ka lidhje me procesin mësimor si: orari i mësimit; pedagogu i lëndës; datat e provimeve; datat e riprovimeve; notat e provimeve; mungesat etj. Sistemi EMS vepron sipas një Rregulloreje e cila është miratura me Vendim të Senatit akademik Nr 25, datë 19.04.2020 ‘Për miratimin e Rregullores për organizimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit në edukim në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Rregullorja përcakton rregullat dhe procedurat e funksionimit të sistemit të menaxhimit në edukim (EMS) për të siguruar përdorimin me efektivitet të tij. Po sipas kësaj Rregulloreje, funksionimi i sistemit EMS udhëhiqet nga

	parimi i ligjshmërisë; parimi i konfidencialitetit dhe parimi i sigurisë. GVJ ju informua nga studentët përdorimi i këtij sistemi dhe marrja e informacionit të duhur dhe të nevojshëm prej tij.						
	Evidencë 4.12. Rregullorja EMS.						
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të takonte punonjës të disa zyrave dhe strukturave, të cilat janë në shërbim të studentëve që studiojnë në UNIEL. Këto struktura kanë si qëllim kryesor studentin duke ju ofruar atyre këshillim dhe orientim në lidhje me procesin mësimor. GVJ u informua se ka një studim tregu që lidhet me programet e studimit që ofron UNIEL në përgjithësi, edhe pse nuk ka një studim periodik të vlerësimit të tregut që lidhet specifikisht me programin e studimit. Institucioni mban kontakte në mënyrë të vazhduar me ALUMNI. Institucioni ka një program për nxitjen e punësimit, i cili mundëson punësimin e studentëve më të mirë brënda Universitetit apo edhe në bizneset private të zonës.						
	Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisë.						
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas informacioneve nga Zyra e Karrierës dhe ALUMNI, institucioni mundohet të mbajë kontakte të vazhdueshme me ALUMNI, kryesisht nëpërmjet email, por edhe me kontakte telefonike kur bëhet fjalë për aktivitete apo shkëmbime të ndryshme që organizohen si nga Universiteti ashtu edhe nga Departamenti i Biologjisë. GVJ u informua se nga 183 ALUMNI të këtij program, 77 prej tyre janë të punësuar.						
	Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisë.						
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UNIEL ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Sipas RVB, Universiteti i Elbasanit ka hartuar Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies. Gjatë realizimit të mësimin online, stafi akademik ka përdorur dhe ka praktikuar platformën Microsoft Teams e cila deri diku i ndihmoi studentët që mos të ndërprisnin procesin mësimor. Orët mësimore janë shoqëruar shpesh edhe me vizita në institucionet shtetërore (AdZM) dhe private (laboratore të ndryshëm) që trajtojnë konkretisht çshtje specifike që lidhen me programin mësimor dhe përmbajtjen e lëndëve të caktuara.</p> <p>Evidenca 6.1. Guida e pedagogut mësimi online nëpërmjet Microsoft teams.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se në rang Universiteti realizohen 2 pyetësorë, njëri institucional dhe tjetri kryesisht për procesin mësimor. Sipas drejtuesve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Departamentit të Biologjisë, programi Master Shkencor në Mbrojtje Mjedisi është një nga programet cilësore që ofrohen në UNIEL si për nga stafi akademik ashtu edhe nga niveli i studentëve. Veçanërisht, ky program studimi ka një staf të kualifikuar dhe premtues për të ardhmen. Gjatë takimit me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se në këtë program i gjithë stafi është me tituj dhe grada dhe kanë një experience mjaft të gjatë në institucion.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ u informua se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe të metodave të mësimdhënies. Njësia e sigurimit të cilësisë, e cila deri para një viti ishte si njësi më vete dhe tashmë përfshihet në Drejtorinë e Kurrikulave dhe të Sigurimit të Cilësisë, është struktura e cila merret me pyetësorët e studentëve. Deri më tani, çdo vit janë realizuar 2 pyetësorë, institucionalë dhe të mësimdhënies. Kjo zyrë harton një draft pyetësor i cili diskutohet dhe miratohet në komisionin në nivel institucional. Pas kryerjes së pyetësorit përgatitet një draft raport që analizon rezultatet, i cili dërgohet sërish në komisionin qëndror në nivel institucional. Pyetësori përgatitet vetëm për studentët. Nuk ka pyetësor për stafin akademik. Rreth 400-500 studentë marrin pjesë në këto pyetësorë. Rekomandimet e dala nga përgjigjet e pyetësorëve paraqiten në raport. Pyetjes së GVJ se si ndiqen rekomandimet e këtyre pyetësorëve, institucioni iu përgjigj se rekomandimet shkojnë tek strukturat përkatëse dhe nga pyetësorët që bëhen çdo vit shikohet si ka ndryshuar çdo rekomandim i përmendur. Krahasimi nga viti në vit është pjesë e raportit të përvitshëm dhe këtu shikohen edhe ndryshimet që janë bërë. Në evidencën 6.6 është paraqitur raporti mbi rezultatit e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në UNIEL, për vitin akademik 2021 – 2022.</p>

	Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Siç jemi shprehur edhe në kriterin e mësipërm, rezultatet e dala nga përgjigjet e pyetësorëve paraqiten në një raport. Raportet publikohen tek faja në internet e UNIEL.		
	Evidenca 6.2. Publikimi i raportit 2021 – 2022.		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ u interesua për metodat dhe mekanizmat për vlerësimin e cilësisë. NJSBC realizon në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët. GVJ ju sqarua se pyetësorët janë një për Institucionin (infrastrukturën, kushtet, etj) dhe pyetësori tjetër është për cilësinë e mësimdhënies. Rezultatet e të dy pyetësorëve janë në nivel institucional. Pyetjes së GVJ a keni pyetësor për stafin, Drejtoria iu përgjigj se deri më tani nuk ka patur pyetësorë të tillë por parashikohet që të përgatitet një për këtë vit akademik.		
	Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.		
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UNIEL ndjek një politikë të kënaqshme për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Duhet të praktikohen dhe të hartohen pyetësorë edhe për stafin akademik.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ dëshmon se Institucioni ka politikat e duhura për sigurimin e cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore (Institucioni ka edhe strukturën e duhur për sigurimin e cilësisë që është Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, funksioni primar i së cilës është siguri i cilësisë sipas parashikimit ligjor dhe akteve nënligjore në mbështetje të tij. NJSBC funksionon pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që prej një viti.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në funksion të sigurimit të cilësisë institucioni përdor pyetësorët për të identifikuar problematikat e mundshme ku përfshihen edhe studentët. Institucioni ka kaluar dy faza akreditimi, njërën me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë (QAA), akreditimi për herë të parë i Universitetit të Elbasanit (proces i cili ishte për të gjithë Institucionet e arsimit të lartë si publike dhe private), si dhe riakreditimin institucional. Procese të tilla e kanë ndihmuar institucionin për të përmirësuar cilësinë dhe për të promovuar vlerat e tij.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,	Pjesë e procesit të sigurimit të cilësisë është edhe rishikimi i programeve mësimore të lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi me qëllim përshtatjen e tyre ndaj zhvillimeve më të fundit dhe dinamikave të problematikave mjedisore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

<p>vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Niveli i punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në këtë program studimi është një tjetër tregues i matshëm i cilësisë. Konkretisht për studentët që mbarojnë këtë program studimi, për një numër që varion nga 10 deri në 15 studentë të diplomuar, ka mundësira për tu sistemuar nëpër vende pune.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Evidencë 1.4. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL. Evidencë 1.15. Rregullore e brendshme e Dep të Biologjisë. Evidencë 1.8. Rregullore e programit të studimit Msc në Mbrojtje Mjedisi.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se Institucioni punon për të arritur rezultate sa më maksimale si në rritjen e procesit mësimor, ashtu edhe në promovimin e stafit akademik. Vlerësimet në kuadër të akreditimit janë procese të cilat e kanë ndihmuar institucionin të evidentojnë dobësitë dhe marrjen e masave për ti përmirësuar. Sipas Evidencës në DVV nr 6.6, GVJ shikon se Institucioni ka paraqitur një Raport mbi bazën e pyetësorëve të realizuara nga Institucioni në nivel Institucional, Qershor 2022. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, pyetësorit i janë nënshtruar studentë që studiojnë në disa programe studimi (10 programe gjithsej, nga të cilat 4 bsc; 1 Mp; 1 Msc; 4 Diploma profesionale). Nuk janë përfshirë në këtë Raport, mendimet e studentëve të programit Msc në Mbrojtje Mjedisi. Sipas RVB rezultatet e pyetësorëve trajtohen në mbledhje dhe takime të ndryshme të zhvilluara si nga Departamentet ashtu edhe nga fakultetet përkatëse dhe publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive</p>	<p>Evidenca 6.6. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor 2021-2022.</p>

dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.				
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në bazë të Evidencave në Dosjen e Vetëvlerësimit, GVJ shprehet se Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e kurrikulës, etj. Pyetësi i ndodhur në Evidencën 6.7 ka një sërë pikash nëpërmjet të cilave i kërkohet mendim studentit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Planin mësimor të programit; - Programet lëndore; - Rregulloret e studimeve universitare; - A kanë informacion për të drejtat dhe detyrat e tyre; - A është e përshtatshme infrastruktura, logjistika apo edhe shërbimet që ofron njësia apo institucioni. <p>Në bazë të përgjigjeve të studentëve, Departamenti merr informacionin për procesin msimdhënës dhe didaktik të porgrameve të studimit që ofron, praktikat mësimore, etj me qëllim mbarëvajtjen e ciësisë së programit të studimit.</p> <p>Evidenca 6.7. Pyetësor i Departamentit të Biologjisë me studentët e programit MSH Mbrojtje Mjedisi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër Drejtoria e Kurikulave, dhe Sigurimit të Cilësisë ka hartuar dhe realizon pyetësorë institucionalë për matjen e performancës. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mbledh dhe publikon të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve. Sipas Evidencës 5.20 Të dhëna rreth punësimin të studentëve që kanë mbaruar studimet në Master i Shkencave në “Mbrojtje Mjedisi”, janë paraqitur të dhëna për 77 studentë që kanë mbaruar studimet në këtë program si dhe punësimi i tyre. Të dhënat janë duke filluar nga brezi i parë i studentëve (2011) dhe deri në vitin 2022. Konstatohet se përgjithësisht studentët e listuar punojnë në Institucione shtetërore dhe private brenda profilit të studimeve të tyre.</p> <p>Evidencë 5.20. Të dhëna rreth punësimin të studentëve që kanë mbaruar MSH Mbrojtje Mjedisi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ shprehet se UNIEL monitoron dhe vlerëson përmes Drejtorive dhe strukturave të posaçme programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimet brenda për brenda institucionit, kanë qënë gjithmonë të frytshme. GVJ u informua se Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon ngushtësisht si me Departamentin e Biologjisë, ashtu edhe me Komisionin e Përhershëm për cilësinë e programit të studimit, mësimdhënien, etj. Janë një sërë urdhërash që janë ngritur në nivel institucional (Evidenca 5.10), por edhe në nivel Fakulteti (Evidenca 5.11). Komisioni i Përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit, është miratur me Vendim të Senatit Akademik Nr 26, datë 27.07.2021. Ky Komision është përgjegjës për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit por edhe të programeve në nivel institucional. Komisioni i Përhershëm në nivel institucional për marrdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierrës, është miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr 25, datë 27.07.2021. Ky komision është përgjegjës për marrdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierrës në nivel institucional. Në përbërje të të dy Komisioneve të lartpërmendur ka përfaqësues të studentëve. Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit nuk ka ndonjë informacion mbi përfshirjen e aktorëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca 5.10. Urdhëri për Komisionet e përherëshme Institucionale në UNIEL.</p> <p>Evidenca 5.11. Urdhëri për Komisionet e përherëshme në Fakultet.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, studentët, stafin akademik, janë të përcaktuara në bazën rregullative të UNIEL. Sipas nenit 18 të rregullores së saj, NJSBC bashkërendon komunikimin midis strukturave të ndryshme, veçanërisht kur procesi i delegohet fakulteteve ose kur një proces vlerësimi që është i organizuar nga Universiteti. Roli bashkëpunues shtrihet në njësi të tjera në Universitet kur procesi ka të bëjë me zhvillimin e personelit dhe mbledhjen e analizave të të dhënave institucionalë. Kjo njësi gjithashtu monitoron cilësinë e programeve të studimit duke ofruar udhëzime, duke mbledhur informacione dhe duke evidentuar probleme të cilat i përcillen njësitë përgjegjëse për zgjidhje.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Anëtarët e NJSBC vizitojnë rregullisht çdo Fakultet dhe Departament dhe ftohen herë pas here që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë, duke u përqëndruar në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit.</p> <p>Evidenca 1.14. Rregullorja e UNIEL.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të</p>	<p>Bazuar në Kodin e Etikës së UNIEL rezultojnë se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës-akademik dhe studentëve.</p> <p>Evidenca 6.5. Kodi i Etikës.</p>

shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.									
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sipas evidencave të paraqitura në Dosjen e Vetëvlerësimit, institucioni nuk ka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit e mund të japin ekspertizë të vlefshme lidhur me cilësinë e programit të studimit. Evidenca 5.10. Urdhëri për Komisionet e përherëshme Institucionale në UNIEL. Evidenca 5.11. Urdhëri për Komisionet e përherëshme në Fakultet.								
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UNIEL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Institucioni nuk ka përfshirë aktorë/ekspertë të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni ka hartuar politika e strategji të qarta në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UNIEL. Aktivitetet e ndërmarra për këtë qëllim kanë qenë gjithmonë transparente dhe publike për studentët apo të gjithë të interesuarit. Evidenca 1.3. Strategjia e Zhvillimit Insitucional 2020-2024. Evidenca 1.4. Rregulloren e UNIEL. Evidenca 1.8. Rregullore për programin e studimit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rregullisht raportet e vlerësimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Evidencë 6.2. Publikimi i Raportit 2021-2022.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shyrtimi i dokumentacionit, por edhe mbështetur në vizitën në Institucion, GVJ shprehet se Njësia e sigurimit të cilësisë e shoqëron punën e saj me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në bazën rregullative si insitucionale, ashtu edhe të Departamentit dhe të programit, të miratura nga Senati Akademik.</p> <p>Evidencë. Minutat e vizitës, Msc. Mbrojtje Mjedisi.</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi në Institucion, konstatohet se institucioni organizon aktivitete promovuese, informuese me personelin akademik, me studentët, aktivitete të cilat shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Sipas evidencës 3.13, Departamenti i Biologjisë, sipas planifikimit, parashikon kohën e nevojshme për konsultime dhe bashkëbisedime.</p> <p>Evidencë 3.13. Orari i konsultimeve me studentët.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 801 783 875">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="783 801 979 875">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 801 1176 875">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 875 783 920"></td> <td data-bbox="783 875 979 920"></td> <td data-bbox="979 875 1176 920" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 963 783 1037">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="783 963 979 1037">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 963 1176 1037">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1037 783 1081"></td> <td data-bbox="783 1037 979 1081"></td> <td data-bbox="979 1037 1176 1081" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave
“Mbrojtje Mjedisi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Elbasanit
Aleksandër Xhuvani”**

Pika të forta dhe afirmime:

1. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është një institucion i arsimit të lartë me traditë institucionale, që krijon një bazë të fortë dhe të qëndrueshme edhe për këtë program studimi.
2. Programi i studimit ka krijuar fizionominë e tij përmes kontributit të stafit akademik dhe atij ndihmës për hartimin e programit dhe të kurrikulës lëndore, bazuar në përvojën e gjatë dhe kualifikimin e plotë me ekspertizë në këtë fushë studimi.
3. Institucioni ka infrastrukturë të plotë dhe të pajisur mirë për të mbështetur procesin mësimor dhe kërkimor shkencor në këtë program studimi, përfshirë salla leksionesh, seminaresh, laboratore, bibliotekën dhe mjedise të tjera të përbashkëta.
4. Programi i studimit mundëson formimin e specilistëve të rinj në fushën e menaxhimit mjedisor dhe krijon lidhjen me tregun e punës, kryesisht duke adresuar nevojat e tij në nivel rajonal.
5. Institucioni dhe njësia bazë kanë hartuar të gjithë dokumentacionin rregullator dhe mbështetës për funksionimin e programit.

Pika të dobëta:

1. Shpërndarja e lëndëve dhe orëve (krediteve) sipas tipologjisë, nuk paraqitet në përpjestimin e duhur për ti dhënë një peshën e duhur lëndëve që i takojnë formimit bazë dhe atij karakterizues kundrejt lëndëve të tjera ndërdisiplinore apo plotësuese. *(Standardi II.1 dhe II.4)*
2. Ngarkesa e stafit të përfshirë, përfshirë edhe disa titullarë lëndësh, nuk është në përputhje të plotë me specifikimet ligjore dhe duhet të rregullohet si për numrin e lëndëve që mbulon çdo PAE në semestër dhe numrin e orëve. Kjo ngarkesë më e lartë mund të ndikojë në disponueshmërinë e stafit për tu angazhuar në aktivitete të tjera. *(Standardi IV.1)*
3. Numri i projekteve shkencore në njësinë bazë të mbështetur nga AKKSHI ose institucione të tjera është i ulët dhe buxheti i institucionit për kërkimin shkencor mbetet i ulët. *(Standardi III.4)*
4. Institucioni nuk ka përfshirë aktorë/ekspertë të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë. *(Standardi VI.4)*

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të rishikojë shpërndarjen e lëndëve në këtë program studimi për të përmbushur kërkesat/rekomandimet e VKM-së, si dhe rekomandohet një vlerësim dhe rishikim në përmbajtjen e lëndëve dhe të programit në tërësi, në mënyrë ai që të krijojë hapësira më të gjera punësimi në fusha të menaxhimit mjedisor si pjesë e industrisë dhe teknologjisë. *(Standardi II.1, II.4, II.5).*

2. Institucioni duhet të rishikojë ngarkesën mësimore për PAE dhe shpërndarjen e orëve/lëndëve përgjatë semestrave, bazuar në specifikimet ligjore në fuqi. *(Standardi IV.1)*
3. Institucioni të bëjë përpjekje për gjenerimin e fondeve për kërkimin shkencor përmes aplikimeve në burime të ndryshme financimi dhe/ose ndarjen më të qartë të fondeve për këtë qëllim nga burime të brendshme. *(Standardi III.4)*
4. Institucioni duhet të përfshijë edhe ekspertë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë, krahas mekanizmave dhe përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve. *(Standardi VI.4)*
5. Në sillabuset e çdo lënde, literatura e detyruar duhet specifikuar qartë dhe referuar botimeve të viteve të fundit, ndërsa literatura e rekomanduar të jetë më e përmbledhur në literaturën e viteve të fundit apo e specifikuar me temat ku ajo ndihmon në zgjerimin e dijeve, si dhe rekomandohet një përdorim më i gjerë prej studentëve i literaturës në sistemin digjital, për shkak të pamundësisë për të kryer porosi për marrjen e literaturës së printuar në kohë të shpejtë dhe me kosto të arsyeshme. *(Standardi II.4 dhe IV.3)*
6. Institucioni duhet të ketë një mekanizëm kontrolli lidhur me plagjaturën në punimet e studentëve. *(Standardi III.3)*
7. Institucioni duhet të përmirësojë mënyrën e planifikimit dhe analizimit të buxhetit për të lejuar identifikimin dhe vlerësimin e qartë të pjesës së buxhetit që shkon për çdo program studimi, përfshirë edhe fondet lidhur me kërkimin shkencor ose bibliotekën. *(Standardi I.3 dhe IV.5)*
8. Institucioni duhet të punojë më shumë për të konkretizuar bashkëpunimet me Institucionet shtetërore dhe private duke i formalizuar në marrëveshje të ngushta bashkëpunimi për realizimin me sukses të praktikave lëndore dhe profesionale. Gjithashtu duhet të realizojë raporte analitike për përfitimin nga këto marrëveshje bashkëpunimi. *(Standardi I.3)*
9. Institucioni duhet të tregojë më kujdes në hartimin e politikave dhe procedurave për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. *(Standardi V.1)*

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences
"Environment Protection" provided by the Higher Education Institution University of
Elbasan "Aleksander Xhuvani"

Strengths and affirmations:

1. University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" is a higher education institution with a long term tradition that creates a solid and stable base for effectively delivering this study program.
2. The study program has created its physiognomy through the contribution of the academic and support staff on the design of the program and its curriculum, based on long experience, comprehensive qualification and required expertise in this field of study.
3. The institution has wide-ranging and well-equipped infrastructure to support the teaching and scientific research process in this study program, including lecture halls, classrooms, laboratories, library and other common facilities.
4. The study program enables the preparation of new specialists in the field of environmental management creating good connections with the labor market, mainly by addressing its needs at the regional level.
5. The institution, including the basic unit responsible for delivering this program of study, have drawn up all the regulatory and supporting documentation for the operation of the program.

Weaknesses:

1. The distribution of subject and teaching hours (and respective credits) based on the typology of subjects, is not proportional with the requirements. The program should aim for higher share towards the main professional subjects versus the interdisciplinary ones. *(Standard II.1 and II.4)*
2. The teaching workload of the engaged staff, including the number of Head of Subjects, is not inline with the legal requirements. The number of subjects for each member of the staff per semester and the number of teaching hours is higher than the foreseen norm, which might impact the availability of staff for other activities. *(Standard IV.1)*
3. The number of scientific projects implemented at the department level (basic unit) supported by National Agency for Scientific Research and Innovation (AKKSHI) or other institutions is limited and the institution's budget for scientific research remains low. *(Standard III.4)*
4. The Institution does not engage external actors/experts in the process of quality assurance. *(Standard VI.4)*

Recommendations:

1. The Institution should revise the distribution of subjects, based on the subject typology, in this study program in order to comply with the legal requirements of the Decision of Council of Ministers and is recommended to provide for an assessment and revision of the content of the courses and the program, to create wider employment opportunities

in the fields of environmental management as part of industry and technology sectors.
(Standard II.1, II.4, II.5)

2. The Institution should adjust the teaching workload of the engaged academic staff, as well as the number of subjects for each semester to comply with the legal requirements.
(Standard IV.1)
3. The involvement of students in scientific research should be more in-depth and comprehensive to enable the build up of research skills and enhance the quality of independent work. *(Standard III.4)*
4. The Institution should engage external experts/actors in the process of quality assurance, together with the current existing mechanisms of academic staff and students' involvement. *(Standard VI.4)*
5. In each subject syllabuses, the obligatory study literature should be clearly specified, by referring to the published materials in the most recent years. The recommended literature should more concised, referred to the recently published papers and books, and linked to specific topics where it supports extending the knowledge provided in the obligatory literature, and also a wider use of digital literature by students is recommended, since it is almost impossible to order printed literature quickly and at a reasonable cost. *(Standard II.4 and IV.3)*
6. It is necessary to establish a control mechanism regarding plagiarism in student works.
(Standard III.3)
7. The institution should improve budget planning and analysis methods to enable clear identification and assessment of funds dedicated to any program of study, including funds related to scientific research or acquiring literature (library). *(Standard I.3 and IV.5)*
8. The Institution should make further efforts on establishing additional cooperations with governmental and private institutions for materializing opportunities for subject and professional practices for students. Furthermore, it should assess the performance and benefits of those cooperation agreements by developing analytical reports. *(Standard I.3)*
9. The Institution should carefully adjust all the study program policies and procedures of admissions, selection, students progress, transfer of studies, assess the knowledge and preparation of theses. *(Standard V.1)*

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS		
	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
VLERËSIMI TËRËSOR			X